



REPUBLIKA E KOSOVËS. - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr.10, Tel.+383/38 2004240, E-mail: xhafer.sh.tahiri@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Xhafer Tahiri Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft Strategjia Zhvillimore e Komunës për periudhën 2020-2025

Të nderuar/a anëtar/e të Kuvendit,

Të bashkëngjitur keni Draft – Strategjinë Zhvillimore të Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2020-2024.

Dokumenti në fjalë iu dërgohet për shqyrtim në lexim të parë në mënyrë që të merret vendim për vënie në diskutim publik dhe miratim në mbledhjen vijuese të kuvendit të komunës.

Mirëpres sugjerimet vërejtjet dhe propozimet gjatë shqyrtimit të parë në mbledhje të kuvendit.

Ju faleminderit paraprakisht.

Me respekt!



KOMUNA E VUSHTRRIË

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL



DRAFT | Institute for Sustainable Development

SHKURTESAT

SKK	Strategjia për Përkrahjen e Prodhuesve
SWOT	Analiza e komunitetit për fuqitë, mundsitë, dobësitë, rreziqet
GLV	Grupi Lokal i Veprimit
MFT	Ministria e Financave dhe Transfereve
LED	Zhvillimi Ekonomik Lokal
BE	Bashkimi Evropian
LEADER	Liaison Entre Actions de Développement de l' Economie Rurale
ZHERR	Zhvillimi Ekonomik Rural dhe Regjional

PËRMBAJTJA

Shkurtesat.....	0
Lista e Tabelave.....	Error! Bookmark not defined.
Lista e Figurave.....	Error! Bookmark not defined.
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	5
HYRJE.....	7
<i>OBJEKTIVI</i>	8
METODOLOGJIA.....	10
Organizimi i grupit punues të komunitetit.....	10
Analizimi.....	10
Zhvillimi strategjik.....	11
Objektivat e Komunitetit.....	12
ORGANIZIMI I GRUPIT PUNUES TË KOMUNITETIT.....	14
<i>PUNËTORIA A, ANALIZIMI I EKONOMISË LOKALE</i>	14
<i>PUNËTORIA B, ANALIZIMI I PARIMEVE EKONOMIKE</i>	20
PROFILI SOCIAL DHE EKONOMIK.....	23
Përgjegësitë e komunës.....	Error! Bookmark not defined.
Organizimi dhe funksionimi i Komunës së Vushtrrisë.....	26
Komitete konsultative.....	26
Organogrami i Komunës së Vushtrrisë.....	27
Pozita gjeografike e Komunës së Vushtrrisë.....	28
Burimet natyrore.....	28
Gjendja aktuale në ekonomi dhe punësim në Komunën e Vushtrrisë.....	Error! Bookmark not defined.
Analiza e Përparësive, Mundësive, Dobësive dhe Rreziqeve (SËOT).....	29
<i>SYNIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE</i>	34
S1. Klimë biznesore dhe zhvillimi i NVMve.....	38
Përkrahja administrative dhe fiskale e bizneseve prodhuese në komunën e Vushtrrisë.....	Error! Bookmark not defined.
Privilegjimi i bizneseve prodhuese.....	Error! Bookmark not defined.
Kartela e privilegjit.....	Error! Bookmark not defined.
Përmirësimi i mëturjes së ofrimit të shërbimeve për bizneset.....	Error! Bookmark not defined.
Klubi i prodhuesve.....	Error! Bookmark not defined.
Rregullimi ligjor për lehtësira fiskale komunale dhe nacionale.....	Error! Bookmark not defined.
Rishqyrtimi dhe ndryshimi i rregulloreve komunale.....	Error! Bookmark not defined.
Zona 0 në tatimin në pronë.....	Error! Bookmark not defined.
Vushtrria Pilot projekt-Lehtësira fiskale (taksat nacionale) për prodhues.....	Error! Bookmark not defined.

Suportimi i prodhuesve nga administrata komunale në institucione tjera.....	Error! Bookmark not defined.
Rritja e kapaciteteve egzistuese dhe potenciale të prodhuesve	Error! Bookmark not defined.
Themelimi i zonës së veçant ekonomike për prodhues.....	Error! Bookmark not defined.
Laboratori i cilësisë dhe prodhimeve.....	Error! Bookmark not defined.
Financimi i prodhuesve lokal.....	Error! Bookmark not defined.
Roli vendimmarrës i prodhuesve në të gjitha organet publike	Error! Bookmark not defined.
Këshilli Ekonomik.....	Error! Bookmark not defined.
Grupi Lokal i Veprimit Vicianum	Error! Bookmark not defined.
Promovimi i prodhuesve të Vushtrrisë në tregun nacional dhe global.	Error! Bookmark not defined.
Dita e prodhuesve vushtrrias-Prishtinë.....	Error! Bookmark not defined.
Festa Hajdeni qaj e ha shëndetshëm	Error! Bookmark not defined.
Projekte dhe aktivitete të tjera që GLV do të jetë bartëse.....	40
Krijimi i qendrës për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe mekanizmave të organizimit të biznesit	51
Qendra e Biznesit.....	51
Qendra komunale për zhvillim ekonomik	52
Këshilli për zhvillim ekonomik lokal	54
Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues të komunës.....	56
Aktivizimi i zonës aktuale.....	57
Zona e veçant prodhuese për tërheqjen e investimeve të huaja	57
Themelimi i qendrës trajnuese dhe inovative (QTI)	57
Qendra promovuese.....	58
Inkubatori	58
Shfrytëzimi i Kapitalit Ekzistues të Komunës.....	58
Prodhimi i energjisë nga burimet e ripërtrirshme (era)	Error! Bookmark not defined.
Rregulloret komunale për stimulimin e biznesit dhe krijimi i fondeve për përkrahjen e bizneseve	59
S2. Zhvillimi i bujqësisë	60
Krijimi i oazave bujqësore	61
Mbrotjtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore.....	61
Aplikimi i Teknologjisë Moderne.....	62
Përfshirja e varieteteve të reja të perimeve dhe përmirësimi racor në blegtori.....	62
Përgatitja Profesionale dhe Stimulimi i Fermerëve	62

Çfarë është GLV dhe koncepti LEADER	63
ZhERR dhe programi LEADER.....	64
Programi LEADER – një histori e shkurtë.....	64
Përse LEADER në Kosovë?.....	65
Shtatë tiparet kyçe të programit LEADER.....	66
Strategjitë Zhvillimore Lokale të bazuara në zonë	66
Partneritetet lokale publiko-private: Grupet Lokale të Veprimit.....	67
Qasja nga poshtë-lartë.....	67
Veprimet e integruara dhe shumësektoriale	67
Inovacioni	68
Bashkëpunimi	68
Rrjetëzimi	68
S3. Zhvillimi i jetës kulturore dhe turizmit.....	69
Shpallja e Vushtrisë si Kryeqytet Historik.....	71
Zhvillimi i Turizmit në Vushtrri.....	71
Ndërtimi Haneve	72
Licencimi i ciceronëve.....	72
Maratona “Vrapojmë me Prodhuesit Vendor”	73
SPECIFIKIMI I NEVOJAVE PËR PROJEKT PROPOZIM	75
PLANET PËR VEPRIM.....	76
Plani i Veprimit – identifikimi dhe hartimi i profilit të bizneseve dhe prodhuesve	76
Plani i Veprimit – Zona e veqant ekonomike për prodhues.....	78
REKOMANDIMET.....	80
SHTOJCA I: KONTURAT E NJË PROJEKT PROPOZIMI	82
Shtojca II: Buxheti i Propozuar për 5 vitet e ardhshme	84
Shtojca III: Përcaktimi i Treguesve Matës.....	85
Shtojca IV: Shporta e projekteve ... Error! Bookmark not defined.	

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Letër pune mbi Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal e prezantuar në këtë dokument është një rishqyrtim më i thellë i komunitetit që thekson fokusin dhe nevojat e komunës. Kjo letër Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL) do të na shpie në formulimin e një strategjisë. Strategjia përfundimtare është një mjet që duhet të implementohet, dhe kërkon ndihmë shtesë dhe kapacitete të zhvillimit të projekteve. Komuna është e vetëdijshme se duhet të sigurojë udhëzime strategjike dhe udhëheqje nëse duhet të arrihen rezultatet konkrete. Kjo përfshinë mbikëqyrjen/përgjegjësinë, koordinimin dhe njerëzit kyç për të përkrahur iniciativat ekonomike. Strategjia e mëhershme e ZHEL dhe Plani Zhvillimor Urban siguron një profil të mirë ekonomik të komunës dhe shumica e të dhënave statistikore dhe informatat tjera në lidhshmëri me karakteristikat e Komunës. Këto dokumente gjithashtu ka elaboruar mbi sektorët e mundshëm për zhvillim ekonomik dhe ka identifikuar shumë projekte, shumica prej të cilave ende nuk janë implementuar, me përjashtim të disa projekteve të infrastrukturës.

Ekipi punues ka përgatitur një raport fillimor dhe një plan të punës për Komunën e cila ka integruar përpjekjet e mëparshme për zhvillim ekonomik. Bazuar në këtë hulumtim, dhe duke formuar lidhjet dhe koordinimin, ky ekip ka kontaktuar një kontraktues për të lehtësuar përmbledhjen e kësaj Letre pune për të pozicionuar Komunën në të ardhmen për veprimet për zhvillim lokal.

Komuna ka organizuar një ekip të gjerë të komunitetit i përbërë nga të gjithë personat kyç të qeverisë lokale, dhe të sektorit publik dhe atij privat dhe veqanërisht të komunitetit të biznesit pasi që objektivë e komunës është që planifikimi dhe implementimi i zhvillimit ekonomik lokal të bëhet nga Qendra Komunale për Zhvillim Lokal që do të jetë strukturë egzekutive dhe

miratuese në të gjitha procesin e zhvillimit ekonomik lokal dhe të strategjisë në përgjithësi. Ky ekip ka kompletuar një proces të analizimit të problemeve, nevojave dhe mundësive potenciale të komunës. Gjithashtu, ekipi ka definuar vizionin e komunës, dhe ka identifikuar strategjitë për zhvillim ekonomik. Kjo punë ka nevojë që të shqyrtohet në kontekst të një profili ekonomik të ri freskuar me të dhëna dhe propozimin mbi Studimin/Hulumtimin e Qëndrimit të Biznesit. Ky proces do të na shpie tek finalizimi i Strategjisë së ZhEL-it të Komunës dhe do të lejojë komunën për të përcaktuar detyrat dhe aktivitetet për të kompletuar një plan të implementimit.

Në këtë Draft Dokument Komuna ka prezantuar planin e saj për të përkrahur zhvillimin e sektorëve kyç potencial si vijon:

- **NVM-të** (përmirsim të ambientit të biznesit dhe stimulim të biznesit egzistues dhe biznesit të ri, harmonizim dhe kordimin të të sistemit arsimor dhe ekonomisë lokale)
- **Prodhimi**
- Bujqësia (subvencionim, vetpunësim, prodhimtari moderne)
- Turizmi
- Brendimi i Komunës

HYRJE

Nën udhëzimet e kryetarit të komunës, komuna e Vushtrrisë ka filluar të punojë në agjendën e strategjisë së zhvillimit ekonomik 2020-2025 me përkrahje Green Art Center Prishtina të bazuar në marrëveshjen e bashkëfinancimit të ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe Green Art Center - Prishtina. Bazuar në këtë marrëveshje Green Art Center përmes një procesi transparent dhe publik ka përzgjedhur Sustainable Development Center si organizatë të specializuar të planifikimit strategjik dhe me staf me përvojë në planifikim dhe zhvillim lokal dhe qasje tjera të zhvillimit bottom-up. Komuna ka formuar një Komitet kordinues të cilët do të vazhdojnë mbajtjen e takimeve kordinuese me organizatën për krijimin e profilit të komunitetit, planifikimit, krijimit dhe evaluimit të strategjisë. Profili i komunitetit është në fazën e dizajnit dhe rishiqimit të të dhënave dhe plotsimit të këtij dokumenti me të dhëna dhe Grupi Punues ka për të koordinuar mbledhjen e të dhënave dhe të krijojë një agjendë zhvillimore.

Grupi Punues është i përbërë nga 5 anëtarë:

1. Muhamet Spahiu – Menaxher i Projektit
2. Merlina Beu Muçaj – Kordinatore
3. xxxxxxxxxxxx – Kordinator nga komuna
4. yyyyyyyyyyyyyy – Anëtar Komuna
5. zzzzzzzzzzzzzz – Anëtar Komuna

Ky dokument përfshin karakteristika fizike, demografike, dhe ekonomike; infrastrukturën dhe shërbimet publike; shërbimet sociale; çështjet e rinisë, minoriteteve dhe gjinore; aktivitetet kulturore; përfshirja e organizatave jo-qeveritare dhe atyre ndërkombëtare; qeverisja lokale; dhe orientimet e zhvillimit strategjik.

Kjo Strategji e cila përcakton orientimin strategjik të komunës që qëllim e ka zhvillimin ekonomik të komunës së Kamenicës do të na shpie në formulimin e qëllimeve dhe objektivave

strategjike të zhvillimit ekonomik të komunës dhe do të shërbej si udhërrëfyes për punën e tyre të mëtejshme gjatë afatit pesëvjeçar. Strategjia përfundimtare është një mjet që duhet të implementohet, dhe kërkon ndihmë shtesë dhe kapacitete të zhvillimit të projekteve. Komuna dhe përgjegjësit e saj janë të vetëdijshëm se duhet të sigurojë udhëzime strategjike dhe udhëheqje nëse duhet të arrihen rezultatet konkrete. Kjo përfshinë mbikëqyrjen/përgjegjësinë, koordinimin dhe njerëzit kyç për të përkrahur iniciativat ekonomike rurale.

Komuna kanë organizuar një ekip të gjerë të komunitetit i përbërë nga personat kyç të qeverisë lokale, të sektorit publik dhe atij privat dhe veqanërisht të grupeve lokale pasi që objektive e zhvillimit ekonomik lokal është që planifikimi dhe implementimi i zhvillimit ekonomik rural të bëhet bashkarisht nga komuniteti i biznesit dhe komuna, që do të jetë fasilitator në të gjitha procesit e zhvillimit ekonomik lokal dhe të strategjisë në përgjithësi. Ky ekip ka kompletuar një proces të analizimit të problemeve, nevojave dhe mundësive potenciale të komunës. Gjithashtu, ekipi ka definuar dhe identifikuar strategjitë për zhvillim ekonomik lokal. Kjo punë ka nevojë që të shqyrtohet në kontekst të një profili social dhe ekonomik të ri freskuar me të dhëna. Ky proces do të shpie tek finalizimi i Strategjisë së LED dhe do të lejojë komunën të përcaktoj detyrat dhe aktivitetet për të kompletuar një plan të implementimit.

Plani Zhvillimor Urban siguron një profil të mirë ekonomik të komunës dhe shumica e të dhënave statistikore dhe informatat tjera në lidhshmëri me karakteristikat e Komunës. Këto dokumente gjithashtu kanë elaboruar mbi sektorët e mundshëm për zhvillim ekonomik dhe kanë identifikuar shumë projekte, shumica prej të cilave ende nuk janë implementuar, me përjashtim të disa projekteve të infrastrukturës.

Ekipi punues ka përgatitur një raport fillimor dhe një plan të punës e cila ka integruar përpjekjet e mëparshme për zhvillim ekonomik lokal. Bazuar në këtë hulumtim, dhe duke formuar lidhjet dhe koordinimin, ky ekip ka kontaktuar një kontraktues (pjesë e ekipit) për të lehtësuar hartimin sa më të arritshëm të strategjisë. Ekipi punues përbëhet nga përfaqësuesit GAC dhe SDC.

Momentalisht, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria e Bujqësisë udhëheq me zhvillimin ekonomik lokal në Komunë dhe punëson disa puntorë që kryesisht merren me objektiva të veqanta të strategjisë. Për shkak që Komuna e Vushtrrisë qenë e nënshtruar një dëmtimi të rëndë si rezultat i luftës, aktiviteti kryesor i Komunës ka qenë rindërtimi i infrastrukturës. Megjithatë, kohën e fundit Drejtoria ka implemetuar projekte dhe programe e aktivitetet që janë disenjuar për të përkrahur NVM-të, bujqësinë dhe blegtorinë. Komuna synon

të zhvilloj Qendra Komunale për Zhvillim duke filuar nga viti i ardhshëm do të merrë përsipër zhvillimin ekonomik lokal.

OBJEKTIVI

Bazuar në nevojat momentale të popullatës, resurset në dispozicion dhe përvoja, Komuna e Vushtrrisë është e pozicionuar për të gjeneruar një strategji të re zhvillimore që synon në përsosjen e strukturës së saj ekonomike, rritjen e punësimit, dhe krijimin e një ambienti për përshpejtimin e përgjithshëm të zhvillimit lokal, prodhimtarisë, bujqësi moderne dhe turizëm.

Kjo strategji e re e zhvillimit ekonomik siguron një vizion për Komunën e cila përfshinë synimet specifike për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe ato të mesme (NVM) dhe të bujqësisë, si dhe programet dhe projektet për ti realizuar këto synime. Komuna e Vushtrrisë ka një shtrirje të bizneseve shumë të sukseshme dhe aktive në tregun e Kosovës dhe tregun e jashtëm që e ushtrojnë aktivitetin afarist aty. Në të vërtetë, Komuna e Vushtrrisë tanimë është duke punuar për të përsosur ambientin për biznes duke iniciuar formimin e Zonave Ekonomike si zona komerciale, artizanale dhe prodhuese.

Qytetarët e përfshirë, duke përfshirë këtu bizneset e mëdha dhe të vogla, ndërmarrësit dhe organizatat aktive në Komunë kanë sprovuar një ndryshim në mendimin rreth zhvillimit ekonomik si rezultat i pjesëmarrjes në këtë qasje të zhvillimit komunal. Këto synimet kërkojnë një riorganizim të konsiderueshëm, ndryshim në proceset e punës në institucionet e qeverisjes lokale, krijimin e mekanizmave të rinj për bashkëpunim ndërmes sektorit publik dhe privat, dhe formimi dhe ndërtimi i kapacitetit të institucioneve dhe organizatave të reja që do të marrin përgjegjësinë për zhvillim ekonomik.

Për të përmbushur këto synime ambicioze, Komuna e Vushtrrisë duhet të mobilizojë dhe angazhojë të gjitha resurset që janë në dispozicion, të cilat resurse qartazi do të jenë të pamjaftueshme për implementimin e tërë planit. Si rrjedhim, Komuna do të kërkojë përkrahje domethënëse nga nivelet tjera të qeverisjes në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare në formë të diturisë, përvojës, dhe ndihmës teknike dhe financiare për të transformuar vizionet dhe synimet e saja në realitet brenda periudhës më të shkurtër kohore të mundshme.

METODOLOGJIA

Zhvillimi i kësaj strategjie ka përfshirë këto hapa:

Organizimi i grupit punues të komunitetit.

Green Art Center dhe Sustainable Development Center ka emëruar ekspert që njëkohësisht është trajner dhe moderor për punëtoritë. E gjithë puna e hartimit të strategjive është menaxhuar nga eksperti. Eksperti ka krijuar ekipin për ëork desk, ka hartuar planin e veprimit për hartimin e strategjisë, duke propozuar agjendën e punëtorive, ekipin ndihmës dhe kordinimin me ekipin kordinues lokal që përfaqësojnë komunën dhe komunitetin në përgjithësi. Në kordinim me komitetin kordinues të Komunës është krijuar lista e pjesmarësve në punëtori 1 dhe 2 dhe janë dakorduar hapat që do të ndiqen deri në hartimin e draftit përfundimtar të strategjisë.

Analizimi

- a) Ekipi i krijuar nga eksperti fillimisht kanë diskutuar dhe hartuar agjendën e punëtorive dhe janë bërë hulumtime nga zyra për profilin socio-ekonomik të lokalitetit dhe komunitetit që e mbulon komuna e Vushtrrisë.
- b) Punëtorja e Parë e organizuar me ekspert, stafin mbështetës dhe komitetin kordinues, ka vlerësuar situatën duke përdorur pesë faktorët: 1) sfidat e deritashme të komunitetit të biznesit dhe të komunës në përgjithësi, performanca e deritashme e trupave institucional të komunës përgjegjëse për zhvillim ekonomik lokal dhe qëllimet e tashme, 2) mjedisi social dhe ekonomik, 3) infrastruktura, 4) resurset njerëzore dhe 5) kualiteti i jetës.
- c) Punëtorja e Dytë (e mbajtur në të njetën ditë me të parën dhe në përbërje të njejtë) ka identifikuar mundësitë duke u bazuar në sfidat e deritashme dhe qëllimet që kanë, është dakorduar për agjendën e punëtorisë 3 dhe 4 dhe janë ndarë përgjegjësitë dhe janë dhënë konturat për antarët e komitetit kordinues në punëtoritë pasuese. Në këtë takim punues janë bërë propozimet për pjesmarrësit

për punëtoritë 3 dhe 4 të cilat kanë dhënë kornizat e profilit social dhe ekonomik dhe janë përcaktuar orientimet strategjike të komunës.

Zhvillimi strategjik

- a)
1. Gjatë Punëtorisë së Tretë janë ftuar dhe kanë marrë pjesë gjithsej 27 pjesëmarrës të cilat kanë prezantuar sektorin publik dhe disa nga grupet e interesit të sektorit privat.
 2. Grupet e komunitetit kanë analizuar strategjinë e tyre të zhvillimit fillimisht duke dhënë një pasqyrë të gjendjes egzistuese të komunitetit të komunës, të realizuara përmes prezentimit nga përfaqësuesit e komunës dhe të facilituara nga eksperti.
 3. Strategjia e mëparshme ka qenë e dukshme përmes projektorit për të gjithë pjesëmarrësit, para punëtorisë për ti caktuar zbrazëtirat. Grupi ka krijuar një vizion, ka zhvilluar synimet, dhe ka identifikuar idetë për përkrahje nga komuna për të zhvilluar sektorin privat.
 4. Pas diskutimit dhe përmes teknikave MOVE janë bërë ndarja e grupeve tematike të cilat fillimisht kanë diskutuar, pastaj kanë punuar në grupe për të nxjerrë SËOT analizën. Pas përfundimit të punës kanë prezentuar punën e tyre në Flip Chart dhe pas çdo prezentimi është diskutuar. Elementet të cilat kanë mund të jenë pjesë e grupeve të tjera janë theksuar dhe nga diskutimet janë nxjerrë elemente të tjera që i kanë takuar punës së grupit por nuk janë theksuar nga grupi punës tematik.
 5. Gjithashtu pas përfundimit të SËOT është diskutuar se cilat janë mundësitë reale që të përfshihen si qëllime dhe objektiva të strategjisë.
- b)
1. Në Punëtorinë e Katërt, grupi ka prezantuar idetë, ka vlerësuar ato ide duke i përdorur kriteret e strukturuar dhe prioritetet e përzgjedhura. Duke u bazuar në të dhenat e pasqyruara dhe diskutuara deri më tani është stimuluar puna e grupeve përmes teknikave Brainstorming, të cilat kanë bërë propozime për objektivat e strategjisë dhe pas propozimit përmes votimit të të gjithë pjesëmarrësve janë nxjerrë objektivat prioritare. Pas votimit objektivat janë diskutuar dhe propozimet për ndryshime të mundshme janë përfshirë në objektivat prioritare.
 2. Duke u bazuar në objektivat prioritare të përcaktuara dhe të dhenat e pasqyruara grupet e rikrijuara për objektiva, kanë bërë propozime për misionin

dhe vizionin e strategjisë dhe përmes teknikave MOVE është votuar për misionin dhe vizionin përfundimtar.

3. Nga struktura profesionale dhe në bazë të përfaqësimit të grupeve lokale që kanë, është bërë ndarja në katër grupe tematike, me bazë në objektiva prioritare. Grupet kanë punuar të ndara për përcaktimin e nën objektivave dhe në pjesën e dytë kanë bërë propozimet për aktivitetet specifike, programet që komuna mund t'i implementoj, si dhe projektet të cilat komuna do t'i implementoj në të ardhëm.

- c) Pas hartimit të draftit të parë në konsultim me organet menaxhuese të komunës do të ftohen pjesmarrësit për diskutim të të arriturave të deritashme dhe hartimin e planit të veprimit për projektet.

Objektivat e Komunitetit

- d) 1. Grupi ka përgatitur një plan të i cili ka përfshirë vizionet e saj, synimet, objektivat, strategjitë, detyrat dhe aktivitetet dhe definimi i roleve dhe i përgjegjësiave.
 - i. Gjithashtu do të propozohen edhe projektet prioritare (nga një për secilin objektivi) që të përpilohet plani i veprimit i detalizuar dhe të jepen konturat për hartim të planeve të mevonshme të veprimit për secilin projekt, aktivitet apo program.
 - ii. Draft përfundimtar do të dërgohet te të gjithë pjesmarrësit dhe do të rekomandohet që të dërgohet edhe te ekspertet tjerë lokal që të merren rekomandime sipas teknikës Delfi.
 - iii. Rekomandimet do të analizohen nëse janë të mundura dhe rekomandimet e aprovuara nga grupi kordinues do të përfshihen në strategji.

Versioni II

Zhvillimi i kësaj Letre Pune ka përfshirë katër hapa:

1. Organizimi i grupit punues të komunitetit.

Kryeshefi i Ekzekutivit dhe Drejtorët e Drejtorive të: Ekonomisë dhe Financave, Planifikimit, Zhvillimit dhe Bujqësisë, Planifikimit Urban, Shëndetësisë, Arsimit dhe Kulturës kanë formuar një grup punues i cili ka qenë i përbërë nga 30 qytetarë të cilët

kanë përfaqësuar sektorin privat, OJQ-të, dhe duke përfshirë edhe qytetarët tjerë të shquar.

2. Analizimi

- d) Punëtorja e Parë ka vlerësuar situatën duke përdorur pesë faktorët ekonomik: 1) qasja në kapital, 2) mjedisi për biznes, 3) infrastruktura, 4) resurset njerëzore dhe 5) kualiteti i jetës.
- e) Punëtorja e Dytë ka identifikuar mundësitë duke analizuar katër parimet ekonomike 1) ndërprerja e rrjedhjes së të ardhurave, 2) hapja e bizneseve të reja, 3) përkrahja e bizneseve ekzistuese, dhe 4) tërheqja e bizneseve kompatible.

3. Zhvillimi strategjik

- e) Gjatë punëtorisë së Tretë, grupet e komunitetit kanë analizuar strategjinë e tyre të zhvillimit. Çdo strategji e mëparshme ka qenë e shpërndarë pjesëmarrësve para punëtorisë për ti caktuar zbrazëtitrat. Grupi ka krijuar një vizion, ka zhvilluar synimet, dhe ka identifikuar idetë për përkrahje nga komuna për të zhvilluar sektorin privat.
- f) Në punëtorinë e Katërt, grupi ka prezantuar idetë, ka vlerësuar ato ide duke i përdorur kriteret e strukturuar dhe prioritetet e përzgjedhura.

4. Objektivat e Komunitetit

Grupi ka përgatitur një plan të ZHEL i cili ka përfshire vizionet e saj, synimet, objektivat, strategjitë, detyrat dhe aktivitetet dhe definimi i roleve dhe i përgjegjësive. Gjithashtu ka zhvilluar një plan të detaizuar për veprim.

ORGANIZIMI I GRUPIT PUNUES TË KOMUNITETIT

Punëtorja e parë mbi Ripërtëritjen Ekonomike Lokale është mbajtur më 11 Mars, 2010. Këshilltarët e ËSI kanë ndihmuar në formimin e grupit punues nga 30 përfaqësues të qeverisë lokale, sektorit publik, OJQ-ve, dhe sektorit privat.

PUNËTORIA A, ANALIZIMI I EKONOMISË LOKALE

Kjo punëtori ka qenë e disenjuar për të analizuar pesë faktorët e rëndësishëm ekonomik 1) qasja në kapital, 2) mjedisi për biznes, 3) infrastruktura, 4) resurset njerëzore dhe 5) kualiteti i jetës. Zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e sektorit privat kanë punuar afër me njëri tjetrin për të analizuar këta faktorë. Kjo punëtori është pjesa e parë e procesit që e shpie komunitetin në një punë më komplekse, zhvillimin dhe implementimin e strategjisë së saj të ZHEL-it. Pjesëmarrësit kanë dëgjuar me kujdes të gjitha raportet, kanë respektuar pikëpamjet e njëri tjetrit dhe janë përkushtuar që të punojnë bashkërisht për ta ndërtuar të ardhmen e tyre.

Tabela në vazhdim përmbledh prezantimet për secilin prej pesë faktorëve:

Tabela 1 – Analiza e Faktorëve—Komuna e Vushtrrisë

Faktori	Problemet	Nevojat	Kapacitetet/Burimet	Mundësitë	Duhet ta di
Qasja Kapital	<p>në 1. Pengesa në infrastrukturën ligjore: dogana; tatimi për lëndën e parë</p> <p>2. Çështjet lidhur me pronësinë</p> <p>3. Privatizimi jo adekuat</p> <p>4. Mospërdorimi i kapaciteteve ekzistuese</p> <p>5. Kostoja e lartë e kapitalit financiar (kamatat e larta dhe afatet e shkurtra)</p> <p>6. Mungesa infrastruktures ne zonë industriale,Infrastrukturë të pamjaftueshme —uji, rryma, rrugët, depot, etj.</p>	<p>1. Eliminojë ose gjej zgjidhjet për problemet</p>	<p>1. Resurset natyrore</p> <p>2. Edukimi adekuat</p> <p>3. Lokacionet për investime</p> <p>Kushtet tokësore dhe klimatike</p> <p>4. Kapacitetet ekzistuese: kompanitë prodhuese në komunë, tregtia, shërbimet, etj.</p> <p>5. Fuqia punëtore e kualifikuar</p>	<p>1. Përdorimi i kapaciteteve ekzistuese</p> <p>2. Toka dhe tërheqja e kapitalit të brendshëm dhe atij të jashtëm</p> <p>3. Krijimi i ndërmarrjeve të reja private</p> <p>4. Rrit vetëdijesimin përmes projekteve kreative</p>	<p>1. Kur do të ndryshojë infrastruktura ligjore;</p> <p>2. Kur do të përfundojë procesi i privatizimit</p> <p>3. Kur do të përdoren kursimet e fondit të trustit të privatizimit nga buxheti i Republikës së Kosovës për zhvillim ekonomik ’</p>

Faktori	Problemet	Nevojat	Kapacitetet/Burimet	Mundësitë	Duhet ta di
Mjedisi Biznes	<p>për</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pengesat në infrastrukturën ligjore 2. Politika fiskale 3. Politika doganore 4. Siguria e industrisë dhe e kapitalit 5. Komunal 6. Infrastruktura 7. Infrastruktura në zona industriale 8. Rryma elektrike 9. Rrugët 10. Prodhuesve vendor u mungon njohuria për standardet ndërkombëtare të prodhimit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjej zgjidhje për problemet 2. Kamatat më të ulëta të bankave 3. Lokacionet e reja për zhvillim të biznesit 4. Trajnimi i specializuar 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Resurset natyrore: toka, kushtet klimatike, tradita kulturore 3. Fuqia punëtore e duhur 4. Kapacitetet prezentë të përpunimit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përdorimi i kapaciteteve prezentë 2. Mundësitë për prodhimtari 3. Mundësia për të tërhequr kapital nga vendorët që punojnë jashtë vendit 4. Përpunimi i produkteve të papërfunduara për eksport 5. Krijimi i 1000 vendeve të punës përmes zonës industriale 6. Realizimi e zonave të reja ekonomike 7. Koordinimi dhe bashkëpunimi me sektorin e biznesit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përforcimi me teknologji të reja 2. Vizitat dhe kontaktet me shtetet e zhvilluara ekonomikisht

Faktori	Problemet	Nevojat	Kapacitetet/Burimet	Mundësitë	Duhet ta di
Infrastruktura	1. Mungesa buxhetore 2. Pengesat në infrastrukturën ligjore: çështjet pronësore 3. Politika e papërshtatshme fiskale 4. Mos implementimi i statusit final 5. Siguria 6. Mungesa e burimeve të ujit	1. Rrugët 2. Sistemet e kanalizimit dhe mirëmbajtjes së tij 3. Rrjeti i ujësjellësit dhe burimeve të ujit 4. Furnizimi i qëndrueshëm, 24-orësh me rrymë elektrike 5. Objektet arsimore dhe ato shëndetësore 6. Përpunimi i ujërave të zeza dhe i mbeturinave	1. Toka 2. Fuqia punëtore e kualifikuar dhe e re 3. Fuqia e lirë punëtore 4. Implementimi i planit për furnizim me ujë të Vushtrisë	1. Gatishmëria e bizneseve për të investuar 2. Gatishmëria e komunitetit për të marrë pjesë 3. Gatishmëria e KK për ti kthyer në mënyrë indirekte të ardhurat vjetore që vijnë nga bizneset (taksat dhe pagesat tjera) për zhvillim të infrastrukturës 4. Klima e mirë dhe përmirsim i vazhdueshëm i kushteve për bujqësi	1. Kushtet prezentë 2. Qëllimet (planet për të ardhmen) 3. Grantet qeveritare 4. Kapitali i KK

Faktori	Problemet	Nevojat	Kapacitetet/Burimet	Mundësitë	Duhet ta di
Burimet Njerëzore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kushtet e këqija ekonomike 2. Të rinjtë që nuk e vijojnë shkollën 3. Mungesa e shkollave që sigurojnë përgatitje profesionale 4. Mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe bizneseve 5. Mungesa e laboratorëve të orëve të praktikës në shkolla 6. Ekspertët që po e lëshojnë shtetin 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Arsimi i orientuar drejt kërkesave profesionale 2. Donatorët:: stimulimi i nxënësve-studentëve 3. Organizimi i kurseve të ndryshme 4. Laboratorët për shkolla 5. Koordinimi ndërmjet institucioneve dhe bizneseve. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shkolla profesionale dhe e zanateve; 2. Studentët 3. Punëtorët e papunësuar 4. Personat e kualifikuar 5. Personat që mund të trajnohen 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shkollat —fakultetet 2. Donacionet—të jashtme dhe të brendshme 3. OJQ-të dhe organizatat profesionale 4. Shkollat profesionale 5. Lokacionet e investimeve 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mekanizmat e identifikimit të problemeve

Faktori	Problemet	Nevojat	Kapacitetet/Burimet	Mundësitë	Duhet ta di
Kualiteti i Jetës	<ol style="list-style-type: none"> 1. Infrastruktura urbane 2. Mungesa e rekreacioneve —fushave sportive 3. Mungesa e qendres megakulturore dhe qendres pedagogjike sportive: teatri, galeritë e artit, muzetë dhe kinematë 4. Papunësia e lartë 5. Mungesa e aktiviteteve kulturore-sportive në rajonet rurale 6. Mungesa e stafit profesional për edukim joformal 7. Shërbimet komunale 8. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore 9. Mungesa e planeve lidhur me ekologjinë (uji i pijshëm i pambrojtur, ndotja e ajrit/tokës) 10. Mungesa e kontrollimit të vendeve për hedhjen e mbeturinave 12. Ndërtimi në tokën bujqësore 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e komunikimit ndërmes Komunës me komunitetin dhe bizneset 2. Krijimi i fondit për zhvillim nga bizneset, komuna dhe komuniteti 3. Rritja e vetëdijesimit për mbrojtjen e natyrës 4. Zhvillimi i turizmit 6. Sigurimi i investimeve në bujqësi dhe investime tjera ekonomike 7. Sigurimi dhe monitorimi i ujit për ujitje 8. Ndërtimi i sistemit hidroenergjetik dhe liqeneve akumuluese 9. Integrimi fshat-qytet 10. Organizmi i shërbimit shëndetësor me standarde Europiane të shëndetësisë 11. Marketingu 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Potenciali turistik: Malet e Sharrit 2. Mosha e re e fuqisë punëtore (fuqia punëtore e lirë) 3. Klima e favorshme dhe kushtet tokësore për një bujqësi kualitative dhe të qëndrueshme: vreshtaria, blegtoria pemëtaria, bletaria, prodhimtaria e perimeve 4. Klubet sportive dhe shoqëritë kulturore 5. Flora dhe fauna ekzistuese 6. Ndërmarrjet ndërtimore 7. Tregtia 8. Projekti “Shtretërit shtëpiak” (home care) 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fuqia punëtore e lirë dhe në dispozicion 2. Fushata për të rritur vetëdijesimin e rinisë kundër shprehive të këqija 3. Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive 4. Fushatat për mbrojtjen e ambientit 5. Ngritja e fermave dhe plantacioneve bujqësore 6. Aktivitetet vullnetare 7. Implementimi i menaxhimit të mbeturinave me PPP 8. Subvencionimi i bujqësisë dhe blegtorisë 9. Përkrahja e plotë e sektorve ekonomik 	

PUNËTORIA B, ANALIZIMI I PARIMEVE EKONOMIKE

Kjo punëtori është dizajnuar për të identifikuar problemet dhe nevojat, kapacitetet dhe mundësitë për përfshirjen dhe implementimin e katër parimeve të rëndësishme të zhvillimit ekonomik.

- Ndërprerje të rrjedhjes (sindromës ekonomike “këpurdhat pas shiut”)
- Përkrahja e bizneseve ekzistuese
- Inkurajimi i ndërmarrjeve e reja
- Tërheq bizneset e reja kompatible

Zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e sektorit privat kanë punuar së bashku për të analizuar këto parime. Tabela në vijim përmbledh prezantimet për secilin prej katër parimeve:

Tabela 2 – Analiza e katër parimeve ekonomike—Komuna e Vushtrrisë

Parimi	Problemet	Nevojat	Kapacitetet/Burimet	Mundësitë	Duhet ta di
Ndërprerja e rrjedhjes	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërprerja e investimeve të gabuara (kopjimi i bizneseve ekzistuese) 2. Mungesa e koordinimit të bizneseve dhe kapitalit financiar 3. Importimi i prodhimeve bujqësore që mund të prodhohen në komunitet 4. Kamatat e larta të kredive 5. Ndalimi i ekonomisë së hirtë 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullimi i infrastrukturës ligjore 2. Krijimi i ambientit stimulues për bujqësi dhe biznese të tjera 3. Organizimi i marketingut të produkteve dhe ngritja e vetëdijes për blerjen e prodhimeve vendore 4. Krijimi dhe prezantimi i projekteve të reja 5. Krijimi i grupit këshillues për të përgatitur strategjinë e zhvillimit ekonomik 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbi 4000 biznese të regjistruara 2. Fuqia e lirë punëtore 3. Kushtet e mira klimatike për zhvillimin e bujqësisë 4. Kapacitetet ndërtimore (materiali i lëndës së parë, gurët) 5. Fermerët ekzistues 6. Llojet e ndryshme të zejtarisë 7. Shërbimet dhe përkrahja nga Komuna 8. Bankat dhe degët e bankave 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Krijimi i zonës prodhuese 2. Ambalazhimi i produkteve 3. Rrushi dhe prodhimet e rrushit 4. Kualifikimi i profesionistëve të duhur 5. Ndërtimi i ndërtesave në tokën koncesion 6. Organizimi i joshjes së kapitalit nga jashtë 7. Zhvillimi i turizmit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sa është investuar në projektet jo të arsyeshme 2. Sa është shpenzuar për ti blerë produktet ushqimore që mund të prodhohen në komunitet 3. Informata zyrtare për dy gjërat e lartpërmendura
Përkrahja e bizneseve ekzistuese	<ol style="list-style-type: none"> 1. Infrastruktura ligjore dhe fizike 2. Politika fiskale 3. Politika doganore 4. Qarkullimi i lirë i dokumentacionit 5. Zendra e biznesit dhe drejtoria per Diasporën 6. Mungesa e energjisë elektrike 7. Ofertat e dobëta për kredi 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kapitali punues 2. Trajnimet 3. Mbrojtja e prodhimeve vendore 4. Përkrahja konkrete për biznese nga Komuna 5. Legalizimi i zonës industriale 6. Nevoja për projekte të reja 7. Bashkëpunimi me profesionistët nga jashtë 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lokacionet egzistuese dhe ato potenciale 2. Pasuria e patundshme 3. Fuqia punëtore 4. Kushtet klimatike ofrojnë mundësi për zhvillim bujqësor dhe të turizmit 5. Industria përpunuese ushqimore dhe e drurit 6. Fuqia e re punëtore 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Koordinimi me bankat 2. Gjej mënyra për ti përdorur burimet natyrore 3. Përdorimi i kapaciteteve ekzistuese 4. Joshja e Diasporës dhe kapitalit “mbështetës” 5. Lehtesirat tatimore 	

Parimi	Problemet	Nevojat	Kapacitetet/Burimet	Mundësitë	Duhet ta di
Inkurajimi i bizneseve të reja	<ol style="list-style-type: none"> 1. Infrastruktura ligjore (thjeshtoj procedurat e regjistrimit të biznesit) 2. Mungesa e infrastrukturës (rryma, uji, rrugët, etj.) 3. Siguria e bizneseve 4. Mungesa e ujit për përdorim bujqësor dhe industrial 5. Taksat e larta 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ofrimi i kredive me kushte të favorshme 2. Trajnimet profesionale (hapja e zyrës për përkrahjen e biznesit) 3. Organizimi i panairove me produkte vendore 4. Zona industriale (ndarja sipas sektorëve) 5. Zonat e reja për investitor 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Toka (toka e mjaftueshme dhe kushtet e favorshme klimatike) 2. Fuqia e re punëtore dhe ekspertët në disa fusha 3. Ekzistenca e shumë bizneseve të suksesshme 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gatishmëria e bizneseve për të investuar 2. Gatishmëria e komunitetit për të marrë pjesë 3. Gatishmëria e KK për të kthyer në mënyrë indirekte të ardhurat vjetore që vijnë nga bizneset (taksat dhe pagesat tjera) për zhvillim të infrastrukturës 4. Klima e mirë dhe kushtet e përshtatshme për bujqësi 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kushtet prezentë 2. Qëllimet (planet për të ardhmen) 3. Bursat qeveritare 4. Kapitali i KK
Tërheqja e bizneseve të reja kompatible	<ol style="list-style-type: none"> 1. Infrastruktura ligjore dhe e ndërtimit 2. Importi i prodhimeve që mund të prodhohen në komunitet 3. Rregulloret doganore 4. Mbrojtja e ambientit, flora dhe fauna 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi ekonomik 2. Zvogëlimi i papunësisë 3. Sigurimi i tregut për mallra 4. Përmirësimi i infrastrukturës ligjore 5. Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zona industriale 2. Kapacitetet e reja për lokacione investive 3. Ekzistimi i shumë barishteve shëndetësore 4. Flora dhe fauna 5. Fuqia profesionale punëtore e mjaftueshme 6. Moshë e re e popullatës 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përdorimi i kapaciteteve të reja dhe tërheqja e mundësive të reja 2. Panairot dhe konferencat e donatorve 3. Sigurimi i granteve 4. Zvogëlimi ose eliminimi i taksave për një periudhë kohore 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Çka mund të bëjë komuniteti për të tërhequr bizneset në komunitet? 2. Kur do të kompletohet procesi i privatizimit? 3. Kur do të ndalet ndërtimi në tokën bujqësore?

PROFILI SOCIAL DHE EKONOMIK¹

Vushtrria ose Vicianumi, siç është quajtur përpara sipas emrit të vjetër ilir, është lokalitet antik, që daton qysh nga mesjeta, edhe para Perandorisë Romake, përkatësisht që nga koha e dardanëve, Viciania në fund të shekullit I para l.K. pushtohet nga Perandoria Romake. Gjatë periudhës së pushtimit romak (I-V) Viciania kishte arritur një zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe kulturor. Pas shkatërrimit të Perandorisë Romake, Viciania mbeti në kuadër të Bizantit. Pas ndarjes së krishterimit më 1054 në katolicizëm dhe ortodoksizëm, pjesa më e madhe e popullatës së Vicianës ishte katolike. Në shekullin XIV Perandoria Osmane filloi të pushtojë Ballkanin dhe me këtë edhe Vushtrrinë. Gjatë shekujve XV-XVIII, Vushtrria ishte ndër qytetet më të mëdha në Ballkan, në Perandorinë Osmane dhe qendër e sanxhakut më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane. Gjatë Luftës së Parë Botërore, përkatësisht gjatë viteve 1915-1918, Vushtrria u pushtua nga Austro-Hungaria.

Në Luftën II Botërore (1941-1945) Vushtrria me rrethinë i takonte zonës së pushtuar nga gjermanët. Në nëntor të vitit 1944, në Vushtrri u vendos administrata komuniste jugosllave deri në luftën e armatosur të popullit të Kosovës, e organizuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe ndërhyrja e forcave të NATO-s (mars-qershor 1999) ku përfundimisht më 17 qershor 1999 u çlirua nga Serbia.

Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veriperëndimore të Rrafshit të Kosovës, në zonën ku afrohen bjeshkët e Shalës dhe Çyqavicës, bri lumit Silnica. Vushtrria është qytet historik i njohur që nga koha bizantine ilire-romake dhe me emërtime të ndryshme. Vushtrria është qendër komunale në të cilën graitojnë 67 lokalitete të banuara. Territori i komunës përfshinë një sipërfaqe prej 345km², gjersa në vitin 1981 në bazë të regjistrimit të popullsisë kishte 65.671 banorë me strukturë të përzier etnike, që rreth 90% i takojnë etnisë shqiptare. Regjistrimi i popullësisë dhe ekonomive familjare të realizuara në vitin 2011 në Komunën e Vushtrrisë i ka dhënë këto rezultate: numri i banorëve të Komunës së Vushtrrisë sipas regjistrimit të popullësisë të kryer në vitin 2011 është 69.870 banorë (duke mos përfshirë një numër të popullësisë serbe që

¹ Profili Socio Ekonomik në këtë dokument është shumë i shkurtër për arsye se do të bëhet dokument I veçant dhe është bërë analiza e faktorve ekonomik që është pjesë e këtij dokumenti.

nuk kanë marrë pjesë në regjistrim), ndërsa dendësia e popullësisë është 202.5 banorë / për km². Komuna e Vushtrrisë ka 11.872 ekonomi familjare, prej tyre 4.890 shtrihen në zona urbane dhe 6.976 në atë rurale, po ashtu ka një popullësi të re dhe të aftë për punë. Lumi Silnica, kanali i sistemit Ibër-Lepenc, përroskat Tërstena, e Sllakocit, e Studimes, e Smrekonicës, e Dumnicës dhe e Brusnikut konsiderohen të jenë rrjeti kryesor hidrografik i saj.

Dy të tretat e territorit të komunës është pjesë rrafshinore. Rrafshi i komunës e sidomos lugina përgjatë lumit Silnica është tokë me potenciale të mundshme për zhvillimin e bujqësisë intensive dhe zhvillim të agroindustrialit.

Komuna e Vushtrrisë është qendër me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, falë tokës pjellore që ofron kushte të volitshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore, ku komuna e Vushtrrisë prin në prodhimin dhe përpunimin e patates.

Vushtrria ka një infrastrukturë relativisht të mirë, duke cituar se përveç rrjetit rrugor ka një lidhje shumë të mirë me qytetet e tjera të Kosovës edhe nëpërmjet rrjetit hekurudhor.

Largësia nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina, është 25 km, ndërsa nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është 42 km.

Figura 1. Pozita e Komunës së Vushtrrisë në territorin e Kosovës



Bizneset aktive të Komunës së Vushtrrisë llogaritet të jenë 1650². Në kohën e fundit vërehet një trend pozitiv në hapjen e bizneseve buqësore të cilat hapin rrugë për biznese prodhuese. Prej këtyre bizneseve kryesisht dominon tregtia me shumicë, pastaj transporti, telekomunikacioni, hotelet, restorantet, industrinë përpunuese, më pas bujqësia dhe pylltaria, si dhe veprimtari të tjera ekonomike, në funksion të ngritjes së mirëqenies së vet qytetarëve. Edhe pse disa prej tyre nuk janë aktive, këto veprimtari ekonomike punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve.

Territori i komunës dhe emërtimet e fshatrave apo vendbanimeve janë të përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave. Komuna e Vushtrrisë është e përbërë prej këtyre fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane:

Akrashticë	Miraçë	Gracë	Galicë
Banjskë	Nedakoc	Gumnishtë	Gllavatin
Balincë	Novolan	Hercegovë	Gojbulë
Beçiq	Ashlan	Karaçë	Maxhunaj
Beçuk	Pantinë	Kollë	Mihaliq
Begaj	Pasomë	Kunovik	Stanoc i Epërm
Bivolak	Pestovë	Kurillovë	Stanoc i Poshtëm
Boshlan	Prelluzhë	Liqej	Stroc
Brusnik	Sfaraçak	Lumadh	Ropicë
Bukosh	Shalë	Studime e Epërme	Samadrexhë
Ceceli	Shlivovicë	Studime e Poshtme	Reznik
Dalak	Shtitaricë	Taraxhë	Zagorë
Dobërllukë	Skoçan	Tërllubuq	Zhilivodë
Druar	Skromë	Vërnice	Dumnicë e Posht.
Duboc	Sllakoc	Vesekoc	Smrekonicë
Dumnicë e Epërme	Sllatinë	Vilanc	Vushtri
Dumnicë e Llugës			

Tabela 1 – Vendbanimet e Komunës së Vushtrrisë³

² Administrata Tatimore e Kosovës

³ Statuti i Komunës së Vushtrrisë -fq 3,28 prill 2011.

Organizimi dhe funksionimi i Komunës së Vushtrrisë

Komitete konsultative

Kuvendi komunal i Vushtrrisë ka këto komitete:

- Komiteti për arsim,
- Komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale,
- Komiteti për ekonomi dhe shërbime publike,
- Komiteti për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit,
- Komiteti për kulturë, rini, sport dhe religjion,
- Komiteti për barazi gjinore.

Administrata komunale e Komunës së Vushtrrisë është e organizuar në 12 drejtori, të cilat menaxhohen nga drejtorët komunalë në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

- Drejtoria për Amdinistratë,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Drejtoria për Arsim,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- Drejtoria për Shërbime Publike,
- Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim,
- Drejtira për Inspektim,
- Drejtoria e Prokurorimit Publik,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Organogrami i Komunës së Vushtrrisë



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

SKEMA ORGANIZATIVE E KOMUNËS SË VUSHTRRIË




FIGURA 2: Organogrami i Komunës së Vushtrrisë

Pozita gjeografike e Komunës së Vushtrrisë

Vushtrria si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i Komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna shtrihet në drejtim veri-jug (gjatësia maksimale afro 34km) dhe diç më e zgjeruar në mes (gjerësia maksimale afro 23 km) me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104.5 km. Territori i komunës gjendet në mes të këtyre koordinatave gjeografike:

X1 : 200 50' 09'' dhe X2 : 210 07' 05'';

Y1 : 420 42' 20'' dhe Y2 : 420 55' 12''.

Territori i Komunës së Vushtrrisë zë afro 3.2% të sipërfaqes të tërë territorit të Republikës së Kosovës. Komuna e Vushtrrisë në veri kufizohet me Mitrovicën, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajin. Në përgjithësi relievi i Komunës së Vushtrrisë është i butë dhe kodrinor. Në përgjithësi relievi i Komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Silnica, me disa degë të tij dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme të lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë, Silnica është lumi me sipërfaqen më të madhe ujëmbledhëse prej 2912 km².

Burimet natyrore

Komuna e Vushtrrisë është mjaft e pasur me pasuri natyrore. Kompleksi i maleve të Çyqavicës është i pasur me florë dhe faunë të zhvulluar si dhe me reliev karakteristik të llojit të veçantë. Në të njëjtin kompleks hasim edhe në llojlojshmërinë e shkëmbinjve dhe mineraleve të pastuduara sa duhet. Komuna e Vushtrrisë, përveç të tjerash, është e krahasuar edhe më shumë vende me potenciale të mineraleve dhe mundësive për eksploatime druri dhe guri, si:

- Duboc – magnezit e porcelan;
- Bivolak – Zhilivodë, Beçuk, Stroc, Gllavatin – thëngjill druri
- Pasomë, Tërllobuq, Smrekonicë dhe Shalë – eksploatimi i gurit
- Gumnishtë dhe Boshlan – pasuri të plumbit dhe zinkut
- Bajnskë – ujë termo-mineral
- Gjelbiëstë dhe Gojbulë – ujë mineral
- Karaçë – burime minerale

Analiza e Përparësive, Mundësive, Dobësive dhe Rreziqeve (SËOT)

Vushtrria, si shumica e komunave në Kosovë, ballafaqohet me sfida të ndryshme zhvillimore, por njëkohësisht, për shkak të pozicionit gjeografik dhe potencialeve që ka, është edhe rast i mundësive për zhvillim të qëndrueshëm në sferën ekonomike, administrative dhe sociale. Në këtë drejtim analiza e përparësive, mundësive, dobësive dhe rreziqeve paraqet një faktor të rëndësishëm për të determinuar objektivat strategjike të komunës në pesë vitet e ardhshme.

Komuna e Vushtrrisë sikur edhe shumica e komunave të Kosovës përballlet me shumë vështirësi dhe sfida në zhvillimin ekonomik lokal, por mbështetur në pozitën gjeografike, potencialet ekzistuese natyrore, resurset dhe veqanerisht në zhvillimin e sektorit të prodhimit, Vushtrria e ka një mundësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Tashmë Vushtrria njihet për kultivimin e patates e cila jep veqanti specifike, kultivuar nga cilësia e tokës shumë e veqant në komunë të Vushtrrisë. Duke e pas këtë potencial, Komuna e Vushtrrisë tani më veq njihet nga prodhues të suksesëshëm të cilët e përpunojnë pataten dhe prodhojnë produkte që janë sorie e suksesit në Kosovë. Duke pas parasysh këto veqori analiza ekonomike e përparësive, mundësive, dobësive dhe rreziqeve është krijuar nga intervistat në distancë të stafit dhe punëtorive.

Ndihmues

<p>Mbrendshëm</p>	<p>PËRPARËSITË</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pozita gjeografike • Resurset njerzore dhe natyrore : toka e punueshme • Bizneset prodhuese • Kultivimi dhe përpunimi i patatës • Pentaria në rritje dhe me mundesi potenciale • Trashëgimia kulutore dhe historike • Bashkëpunimi institucional dhe performanca e mirë • Binjakëzimet me qytete/komuna të fuqishme • Aftësimi profesional • Industri tradicionale: prodhimi bujqësor, përpunimi i ushqimit, druri • Menaxhimi i mbeturinave • Zonat e mëdha të tokës pjellore bujqësore me sisteme funksionuese të ujitjes • Hapsira rekreative dhe sportive • Vendosja e paqes dhe rendit me shkallën e ulët të krimit
<p>Jashtëm</p>	<ul style="list-style-type: none"> • MUNDËSITË Kushtet e favorshme dhe një traditë në prodhimin e produkteve bujqësore • Zont industriale • Infrastrukturë e përshtatshme • Resurse humane profesionale • Përkrahja e prodhuesve lokal (hapsira dhe marketingu) • Potencial i shkëlqyeshëm për zhvillimin e sektorit të agrobiznesit për shkak të interesit të investitorëve për zgjerimin e kapaciteteve të agro-përpunimit • Programe trajnuese për punëtor • Diaspora e fuqishme • Panaire për punësim dhe për prodhues lokal • Turizmi dhe agrobiznesi • Zhvillimi i perimtarisë

Tabela 2. Elementë e identifikuar të Fuqive dhe Mundësive të SËOT sipas punëtorisë.

Pengues

Mbrendshëm	<p>DOBËSITË</p> <ul style="list-style-type: none">• Buxhet i kufizuar• Numër i pamjaftueshëm i stafit profesional• Procedurat e zgjatura të prokurimit• Niveli i lartë i papunësisë• Vonësa në menaxhimin e buxhetit• Përvojë e pamjaftueshme e komunitetit të biznesit dhe pushtetit vendor në funksionimin e një sistemi të ekonomisë së tregut• Konkurrenca jo lojale• Kapacitete të kufizuara infrastrukture në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore• Mungesa e kooperativave bujqësore• Mos organizimi i bizneseve dhe fermerëve• Niveli i ulët i bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe institucioneve arsimore• Mungesa e platformave promovuese• Mos implementimi i LED• Kompetencat e padefinuara Qeveri-Komunë• Mënyrat jo të duhura të subvencionimit të bujqësisë• Bujqësi e paorganizuar
Jashtëm	<p>RREZIQET</p> <ul style="list-style-type: none">• Humbja e tokës bujqësore• Migrimi të rinjëve të kualifikuar• Mungesa e politikave për mbrojtjen e prodhuesve vendor• Mos implementimi i strategjisë si pasoje e ndryshimit të pushteteve• Mungesa e fondeve komunale për të mbështetur NVM-të• Humbja e tokës bujqësore për shkak të zhvillimeve të mëdha të paligjshme• Mbështetja selektive e Qeverisë për Komuna• Konkurrenca jolojale• Politikat kuadrore në sektorët publik• Vlerësimi i cilësisë së produkteve , mungesë e laboratorëve• Humbja e tokës bujqësore

Tabela 5. Elementë e identifikuar të Dobësive dhe Rreziqeve të SËOT sipas punëtorisë.

ORIENTIMI STRATEGJIK

Grupi komunal për zhvillim ekonomik lokal i ka definuar vizionet e tij, synimet strategjike dhe idetë për projekte bazuar në rezultatet e mbledhura përmes intervistave direkte dhe në distancë.

VIZIONI

Komuna e Vushtrisë është mjedis i përshtatshëm për ndërmarrësi dhe ka ndërtuar strukturë funksionale ndërlidhëse ndërmet sektorëve të bujqësisë, blegtorisë, edukimit dhe ndërmarrësisë.

Vushtrria apo “Vicianum” është “shtëpi” e bizneseve dhe është identifikim i qëndrës së dikurshme historike dhe tregate.

MISIONI

Si zonë e veçant historike do të marrë identitetin e saj të dikurshëm si qendër për bizneset prodhuese dhe aktivitetet tjera të biznesit duke rritë mirëqenjen ekonomike dhe sociale për të gjithë qytetarët e saj.

Zhvillimi ekonomik lokal do të arrihet si bashkëveprim i zhvillimit të ambientit biznesor, prodhimtarisë dhe kulturave bujqësore, me sistem arsimor të harmonizuar me ekonominë lokale duke siguruar standard të mirëqenë jetsor dhe social.

Administrata komunale do të jetë në shërbim të plotë të qytetarve dhe bashkëpunëtor i akterëve të ekonomisë lokale.

QËLLIMI I STRATEGJISË

Sikur e gjithë Kosova edhe Vushtrria ka potencial të theksuara të fuqisë së re punëtore por sfidat janë të njejta: kualifikimi i ulët adekuat. Kjo kërkon arsim cilësor, mbështetje të punësimit përmes rritjes së investimeve dhe mbështetjes së sektorit privat, krijim të klimës së favorshme për të zhvilluar biznes, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojë në rritjen e punësimit dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët.

Përmes zhvillimit dhe bashkëpunimit ekonomik rajonal, për të krijuar mundësi të barabarta investive në prodhim dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj, me infrastrukturë cilësore, mjedis të pastër dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, të cilat janë në pajtim me standardet e BE-së. Në pesë vitet kaluara vizioni i Vushtrrisë është që të jetë komunë me rrije të lartë ekonomike dhe nivel të ulët të papunësisë në Kosovë, me administratë moderne komunale dhe arsim të nivelit evropian. Konsiderohet që këto qëllime strategjike më shumë i përkasin nivelit qëndror, pra Qeverisë së Kosovës përderisa Vushtrria ka potenciale shumë specifike për të cilat mund ti zhvilloj më tutje dhe të i vë në dispozicion të zhvillimit ekonomik lokal.

Duke u mbështetur nga planet dhe strategjitë e kaluara, Komuna e Vushtrrisë do të zhvillojë dhe do të ngrisë mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe fizike, do të sigurojë një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e saj nëpërmjet këtyre shtyllave:

- **NVM-të** (përmirsim të ambientit të biznësit dhe stimulim të biznesit egzistues dhe biznesit të ri, harmonizim dhe kordimin të sistemit arsimor dhe ekonomisë lokale)
- **Prodhimi**
- Bujqësia (subvencionim, vetpunësim, prodhimtari moderne)
- Turizmi
- Brendimi i Komunës

Në diskutime me akterët komunal, kryesisht me kryetarin e komunës qëllimet e Vushtrrisë janë më specifike tani, duke u orientuar në zhvillimin e ekonomisë lokale me qasje specifike ndaj NVMve, duke e specifikuar edhe më tutje me plane dhe hapa konkret zhvillimin e prodhimit duke qenë se tanimë Komuna e Vushtrrisë është e njohur për prodhues të sukseshëm të cilët kanë zhvilluar brende të besueshme jo vetëm për konsumatorin kosovar.

SYNIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Si rezultat i hulumtimit dhe analizimit të saj, Komuna ka identifikuar aftësitë për të krijuar ndërmarrjet si një forcë që mund të jetë çelës për të krijuar ndërmarrje të reja, zhvilloj ato ekzistuese, dhe të inkurajoj krijimin e vendeve të punës.

Gjatë zhvillimit të aftësive për të krijuar ndërmarrjet, Vushtrria duhet gradualisht ta ringjallë administratën komunale në shërbim të bizneseve, e cila do të kontribuojnë për një kualitet më të mirë të jetës për qytetarët e saj. Komuna do të përpiqet të zhvilloj sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe të kulturës me qëllim që të transformojë Komunën e Vushtrrisë në një qendër dinamike të ndërmarrjeve.

Gjatë procesit të punëtorisë (intervistave), janë anë shqyrtuar ide të programeve për arritjen e këtyre synimeve strategjike. Idetë e propozuara ishin vlerësuar si dhe janë prezantuar këto konkluzione. Vazhdimi i procesit kërkon analizim më të thellë për të siguruar se projekt propozime kualitative do të prezantohen te akterët lokal dhe tek komuniteti i donatorëve.

Objektivat për secilin synim strategjik gjithashtu janë prezantuar. Këto qëllime janë konturuar nga nën-grupet dhe pastaj janë vlerësuar. Si rezultat, Komuna ishte në gjendje të identifikojë tri projektet me prioritet të lartë për secilën synim të saj.

<i>SYNIMET STRATEGJIKE</i>		
SYNIMI STRATEGJIK 1	SYNIMI STRATEGJIK 2	SYNIMI STRATEGJIK 3
Klimë biznesore të përshtatshme për biznese ekzistuese dhe tërheqjen e investimeve të jashtme në me fokus në prodhim	Bujqësi moderne me produkte kualitative industriale dhe të konsumit direkt për tregun lokal, kombëtar dhe të jashtëm.	Ngritja e kualitetit të jetës kulturore dhe zhvillimit të turizmit

Vushtrria në vazhdimësi e ka avancuar administratën komunale me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal duke filluar me krijimin e drejtorisë së veçant për këtë qështje. Tani

Vushtrria e ka një zonë industriale e cila ka sipërfaqë rrethë 14 ha e cila do të shërbej për arritjen e synimit të parë strategjik, megjithëse sipërfaqja konsiderohet e vogël për absorbimin e të gjitha kërkesave dhe për plotsimin e këtij synimi. Duke u mbështet në sipërfaqet e tokave që tani i ka në dispozicion AKP, Komuna mnedon që në këtë periudhë të e zhvilloj edhe një zonë të veqant industriale të destinuar vetëm për investitor prodhues të jashtëm.

Tani më Vushtrria është e njohur për disa produkte të perimtarisë siq është patatja e cila veq kultivohet me sasi të medha në Vushtrri dhe destinohet për industrinë lokale të përpunimit dhe prodhimit të produkteve të industrisë ushqimore. Gjithashtu potencialet në toka bujqësoreë pjellore e mundësojnë që Vushtrria të shënderrohet në një zonë të kultivimit të perimtarisë, kryesisht të destinuar për industri prodhuese dhe përpunuese.

Vushtrria apo siq është e njohur në histori si Vicianumi është e njohur për histoinë e veqant të saj si qendër tregtare dhe kulturore. Duke u mbështet në këtë veqanti, jeta kulturore mund të zhvillohet dhe veqohet në Vushtrri, ndërsa duke u mbështetur po në të njetin fakt mund të zhvillohet turizmi lokal, si historik dhe kulturor, rural dhe ai sportiv.

SYNIMI STRATEGJIK 1**KLIMË BIZNESORE DHE ZHVILLIMI I NVM-ve**

OS 1.1	OS 1.2	OS 1.4	OS 1.5
Përkrahja e prodhuesve	Krijimi i qendrës për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe mekanizmave të organizimit të biznesit	Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues të komunës	Rregulloret komunale për stimulimin e biznesit dhe krijimi i fondeve për përkrahjen e bizneseve

SYNIMI STRATEGJIK 2**ZHVILLIMI I BUJQËSISË**

OS 2.1	OS 2.2	OS 2.3	OS 2.4
Krijimi i Oazave Bujqësore (koperativave bashkëkohore)	Mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore	Mundësimi i aplikimit të teknikave dhe teknologjive moderne bujqësore	Sigurojë përgatitje profesionale dhe stimulim të bujqësisë

SYNIMI STRATEGJIK 3**ZHVILLIM I JETËS KULTURORE DHE TURIZMIT**

OS 3.1	OS 3.2
Vushtrria qendër historike	Zhvillimi i turizmit kulturor, rural dhe sportiv

SYNIMI STRATEGJIK 4**ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PRODHUESE TË ENERGJISË SË RIPËRTRITSHME DHE MINERALOGJISË****OS 3.1**

Prodhimi i energjisë së ripërtritshme

OS 3.2

Krijimi i vendeve të punës në mineralogji

S1. Klimë biznesore dhe zhvillimi i NVMve

Si pjesa më e madhe e Kosovës ehe Vushtrria nga lufta del me një ekonomi të shakttruar e cila deri atherë ishte e ndërtuar në sektorin shoqëror. Pas luftës përmes AKM së athershme dhe tani AKP shumica e ndërmarrjeve shoqërore janë privatizuar por si pasojë e pamundësisë së adaptimit me rrethanat e reja prodhimitaria e tyre është ul ndjeshëm. Tani në Vushtrri fatmirsisht ka prona të menaxhuara nga AKP të cilat mund të përdorën si potenxila për ndërtjen e kushteve dhe përmirsimit të ambientit për të bërë biznes në komunë eVushtrrisë.

Sot në komunën e Vushtrrisë janë krijuar dhe zhvilluar shume prodhues të ccilat kanë ndikuar zhvillimin e të gjitha hallkave të ekonomisë lokale, duke u nis nga bujqësia prej të cilëve ata e marrin lëndën e parë.

Që nga miratimi i ligjit për vetqeverisje lokale, Republika e Kosovës ka hyrë në një fazë të rëndësishme të reformimit të vetqeverisjes lokale dhe decentralizimit. Në pajtim me vlerat dhe arritjet e botës perëndimore, institucionet e Kosovës kanë filluar procesin dcentralizimit me qëllim që vendimmarrja të afrohet sa më afër qytetarve dhe qytetarët të jenë pjesë aktive e zhvillimit ekonomik të komunës së tyre. Njëkohsisht reformimi e vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimi shërbejnë edhe si mekanizëm për integrimet evropiane si një prioritet për institucionet e Kosovës.

Me qëllim të arrijës së objektivave të rritjes së efikasitetit të shërbimeve të qytetarve dhe zhvillimit ekonomik lokal me ligj është rregulluar edhe pjesëmarrja e qytetarve në vendimmarrjen lokale nga ku janë përcaktuar organet komunale dhe administrata, aktet që nxirren nga organet e komunës, marrdhënjet ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal të qeverisjes etj.

Zhvillimi ekonomik përfshim një numër të partnerëve – organizatave qeveritare, jo-qeveritare, komunitetit dhe ato të sektorit privat – dhe mund të qojnë në përfundime të ndryshme – krijimin e vendeve të punës, rritjen e produktivitetit apo përmirsimin e cilësisë së jetës.

Si mund të ndertohej një ekonomi e fortë lokale? Çdo komunitet ka një grup unik të kushteve lokale që janë në gjendje të forcojnë apo zvoglojnë potencialin e zhvillimit ekonomik lokal, dhe kjo është një prej kushteve që përcaktojnë përparësit relative të

një zonë në aftësinë e saj për të tërhequr, të gjenerojë dhe të mbajë investimet. Atributet ekonomike, sociale dhe fizike të një komuniteti janë udhëzues në hartimin e dizajnit, dhe sigurojn qasje të mirë në implementimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal. Për të ndërtuar një ekonomi të fortë lokale, praktikat e mira dëshmojnë se secili komunitet duhet të ndërmarrë një proces bashkëpunimi për të kuptuar natyrën dhe strukturën e ekonomisë lokale, dhe të kryejnë një analizë të forta të zonës, të përparësive, të dobësive, të mundësive dhe kërcënimeve të mundshme. Kjo do të shërbejë për të nxjerrë në pah çështjet kryesore dhe mundësitë në ekonominë lokale.

Kush merret me Zhvillimin Ekonomik Lokal? Ndërmarrje private të suksesshme dhe partneritetet publiko-private produktive krijojn pasuri në komunitetet lokale. Ndërmarrje private megjithatë, kërkojn një mjedis të përshtatshëm pozitiv që ofron prosperitet. Qeveria komunale ka një rol thelbësor në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e biznesit dhe suksesit. Nga natyra e saj, zhvillimi ekonomik lokal është një partneritet në mes të sektorit të biznesit, interesave të komunitetit dhe qeverisë komunale. LED është planifikim strategjik nga qeveria lokale në bashkëpunim me partnerët e sektorit publik dhe privat. Zbatimi kryhet nga partneri publik, privat dhe jo-qeveritarë në përputhje me aftësitë e tyre dhe pikat e forta.

SYNIMET SPECIFIKE	synimi specifik 1
	○ 1. <u>Krijimi i lehtësirave administrative dhe fiskale për prodhuesit.</u>
	synimi specifik 2
	○ <u>Rritja e kapaciteteve egzistuese dhe potenciale të prodhuesve.</u>
	synimi specifik 3
	○ <u>Promovimi i prodhuesve të Vushtrrisë në tregun nacional dhe global.</u>
	synimi specifik 4
	○ <u>Inkudrimi i prodhuesve si pjesë të vendimmarrjes publike.</u>

Kryetari i Komunës ka shprehur qart orientimet e tij strategjike për përkrahjen e prodhuesve të Komunës së Vushtrrisë e cili opinion ka qenë bazë për zhvillimin e tyre nga grupet punese dhe nga punëtoritë që janë mbajtur me zyrtar komunal, komunitetin e biznesit dhe me përfaqësues të shoqërisë civile. Komuna e Vushtrrisë duhet të bazohet në këtë dokument strategjik dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme në rregullativën ligjore, në buxhet dhe ky dokument të jetë orientimi për planifikimet e ardhshme të buxhetit të Komunës. Zyrtarët kryesor komunal janë shprehur të gatshëm të implementojnë të gjitha aktivitetet të cilat dalin nga ky plan, duke filluar në përfshirjen e bizneseve prodhuese në vendimmarrjen publike përmes organeve të cilat janë të propozuara në këtë dokument, në krijimin e mekanizmave të cilët e mundesojnë mbështetjen direkte dhe indirekte të bizneseve prodhuese dhe ndryshimeve institucionale të cilat e mundesojnë bashkëveprimin e organeve publike në harmoni me nevojat dhe qëllimet e komunitetit të biznesit.

S1. Përkrahja administrative dhe fiskale e bizneseve prodhuese në komunën e Vushtrrisë

OBJEKTIVI SPECIFIK 1		
Përkrahja administrative dhe fiskale e bizneseve prodhuese në komunën e Vushtrrisë		
1	2	3
Privilegjimi i bizneseve prodhuese	Rregullimi ligjor për lehtësira fiskale komunale	Suportimi i prodhuesve nga administrata komunale në institucione tjera

Bazuar në përvojat e deritashme e komunësë Vushtrrisë mbështetja për prodhuesit ka qenë kryesisht morale dhe ë shumë drejtëpërdrejt dhe e pakursyer. Komuna e Vushtrrisë ka bashkëpunuar ngusht me fermerë, prodhues, kultivues dhe zejtarë dhe ka shërbyer si një urë lidhëse ndërmjet tyre dhe organeve komunale. Asistimi teknik dhe për proshues është bërë kryesisht nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komuna e Vushtrrisë, pasi që prodhuesit kanë qenë të informuar që aplikimet eventuale për grante, subvencione apo kërkesa tjera.

Është e qartë se Komuna e Vushtrrisë si edhe pjesa ma e madhe e Kosovës ballafaqohet me **burime të reduktuara për financimin** e zhvillimeve dhe projekteve kapitale, që ndërlidhet fuqishëm me çështjen e zhvillimit ekonomik me politikat e ekonomike, papunësinë dhe varfërisë në aspektin social dhe lidhet me sektorin publik në përmirësimin e infrastrukturës publike. Kufizime edhe më të mëdha janë në kategorinë e shpenzimeve të subvencioneve në mënyrë që komuna të mund të përkrah finaciarisht bizneset prodhuese ekzistuese apo bizneset e reja.

Në këto kushte, krijuesit e politikave ekonomike sfidohen me nevojën e nxitjes së investimeve të reja. Prandaj krijimi një ambienti miqësor afarist dhe ambientit adekuat institucional, për tërheqjen e investimeve të jashtme të drejtëpërdrejta imponohet si një nga prioritetet më të rëndësishme të politikave ekonomike dhe reformës ekonomike.

Bazuar në këto kushte, pjesmarrësit kanë vlersuar që qëllim kryesor i prioritetit 1 të jetë privilegjimi i bizneseve prodhuese në të gjitha institucionet lokale dhe nacinale, përfshirë edhe ato të partneritetit publiko-privat siq është GLV-ja. Privilegjimi i bizneseve prodhuese

Komuna e Vushtrrisë është e dalluar për nga bizneset prodhuese sidomos ato biznese biznese të cilat si lëndë të parë përdorin produktet bujqësore dhe blegtorale të kultivuara në komunën e Vushtrrisë nga fermerët lokal dhe nga vet bizneset prodhuese.

Përveq bizneseve prodhuese të industrisë përpunuese dhe ushqëimore Vushtrria është e njohur edhe për bizneset e industrisë së rëndë të cilat në të kaluarën (para luftës) kanë qenë bazë e zhvillimit ekonomik dhe punësimit në komunë.

Zejtaria gjithashtu është shumë e njohur dhe e zhvilluar në Vushtrri e cila ka një traditë të lashtë dhe lidhet me vet historikun e qytetërimit dhe kulturës së vjetër vushtrriase.

Disa nga veprimet, projektet dhe programet që komuna e Vushtrrisë duhet të i implementoj si veprime të administratës komunale për privilegjimin e prodhuesve vushtrrias janë të sqaruara më poshtë.

Kartela e Privilegjit

Kartela e privilegjit është një kartelë të cilën komuna e Vushtrrisë, Drejtoria për zhvillim ekonomik lokal e lëshon për prodhuesit lokal duke u mbështetur në kriteret e caktuara.

Kartela e privilegjit përmban disa privilegje për mbajtësin e kartelës duke i lejuar biznesit që mos të kushtëzohet në pagesë/mospagesë të taksave komunale, të ketë të drejtën e shërbimeve të mënjëhershme (specifikohet lista e shërbimeve), të kenë një ditë dhe kohë të caktuar në muaj që të takohen me kryetarin dhe stafin politik dhe administrativ përgjegjës për të diskutuar për sfidat, mundësitë dhe nevojat e tyre.

Përmirësimi i mëturjeshtëm i ofrimit të shërbimeve për bizneset

1. Standardizimi i shërbimeve për biznese.
2. Krijimi i një regjistri të të gjitha shërbimeve publike, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Regjistri do të shërbejë për ndërtimin eventual të sistemeve informative të integruara mes shërbimeve të ndryshme.
3. Krijimi i një baze qendrore të të dhënave për shërbimet publike prej së cilës sistemet e ndryshme informative do të mund të nxjerrin informata, duke e eliminuar kështu nevojën që qytetarët dhe bizneset të japin informata të cilat shteti tashmë i ka në dispozicion.

4. Vendosja e një sistemi të freskimit të rregullt të informatave lidhur me ofrimin e shërbimeve brenda Ministrisë së Administratës Publike për tërë Administratën Publike.
5. Harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit për shërbimet në përputhshmëri me Direktivën e BE-së për shërbimet.

Klubi i prodhuesve

Klubi i prodhuesve është një organ i regjistruar zyrtarisht i cili mbështetet nga komuna e Vushtrrisë. Komuna e mbështet klubin e prodhuesve në sigurimin e premisave për funksionim, administratë dhe shpenzime tjera operationale. Selia e Klubit të Prodhuesve sugjerohet të jetë në komunë.

Kryetari i Komunës dhe drejtori i departamentit për Zhvillim Ekonomik Lokal, automatikisht është pjesë vendimmarrëse e Klubit të Prodhuesve.

Funksioni i Klubit të prodhuesve është që të siguroj lehtësira për prodhues dhe gjithashtu të jetë organ këshilldhënës jo-formal për Kryetarin e Komunës.

Rregullimi ligjor për lehtësira fiskale komunale dhe nacionale

Ekonomia e tregut si orientim zhvillimor i ditëve të sotshme është padyshim një ndër faktorët që dita ditës po ndikon në iniciativat e qytetarve për të krijuar kushte për punësim apo vetpunësim. Deri më tani është dëshmuar se sektori prodhues ka potenciale për punësimin e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Duke u mbështetur nga ky fakt ku prodhuesit kanë pozitë dominuese në komunë (dhe synohet nga shumë komuna dhe vende tjera) atherë komuna duhet të shqyrtoj dhe ndryshoj shumë nga rregullorët të cilat krijojnë lehtësira për bizneset prodhuese.

Rishqyrtimi dhe ndryshimi i rregulloreve komunale.

Rregullorët komunale janë hartuar në mënyrë që prodhuesit të identifikohen dhe trajtohen njëjtë me të gjithë bizneset andaj nisur nga ky fakt Komuna duhet të rishqyrtoj të gjitha rregullorët komunale për privilegjimin e prodhuesve lokal.

Zona 0 në tatimin në pronë

Për të i mundësuar bizneseve prodhuese lehtësira të prekshme në tatimore sugjerohet që të shtohet një zonë të quajtur Zona 0, në të cilën hyjnë bizneset prodhuese sipas kategorive të specifikuar paraprakisht.

Kjo zonë tatimohet me normë tatimore shumë të ulët, mundësisht vlerë e afërt me zero.

Vushtrria Pilot projekt-Lehtësira fiskale (taksat nacionale) për prodhues

Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Klubin e Prodhuesve të hartojnë një pilot projekt të cilin do të i propozojnë Ministrisë së Financave dhe transfereve që Komuna e Vushtrrisë të jetë Pilot Projekt për lehtësira fiskale të prodhuesve. Lehtësirat mund të përfshijnë subvencionimin e pagave për punëtorët e rinjë që punojnë në prodhim, në përqindje të caktuar.

Përderisa niveli nacional të implementoj projektin për lehtësira, komuna mund të e ndaj një fond simbolik nga subvencionet për përkrahjen e prodhuesve duke ia paguar një pjesë të pagës punëtorve të rinjë në prodhim.

Suportimi i prodhuesve nga administrata komunale në institucione tjera

Klubi i prodhuesve si organizim i përbashkët i komunës dhe prodhuesve të ndërtojnë kapacitete të cilat i ofrojnë bizneseve asistencë teknike dhe profesionale. Administrata e klubit do të i informoj dhe ndihmoj bizneset në hartimin dhe përpilimin e projekt propozimet në favor të prodhuesve.

S2. Rritja e kapaciteteve egzistuese dhe potenciale të prodhuesve

Një ekonomi e tregut është më efikase dhe e aftë për të gjeneruar rritje ekonomike nëse shteti ndërhyt sa më pak tek ndërmarrjet private. Por, roli i shtetit është i pashmangshëm për të stimuluar krijimin e ndërmarrjeve konkurruese në sektorët me vlerë të lartë të shtuar. Industrinë e tilla bëjnë që rritja ekonomike të prodhojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. E ardhmja e zhvillimit të Kosovës dhe gjithashtu e Komunës së Vushtrrisë, varet nga fushëveprimi dhe produktiviteti i ndërmarrjeve. Duhet inkurajuar krijimi, qëndrueshmëria dhe produktiviteti i ndërmarrjeve private lokale si dhe tërheqja e investimeve të huaja. Kosova tashmë ka arritur të konsiderueshme në këtë fushë, në veçanti renditja në raportin e “Të Bërit Biznes”. Në anën tjetër, kjo nuk është e mjaftueshme. Prandaj, komuna e Vushtrrisë duhet të vazhdojmë tutje duke përkrahur në vazhdimësi prodhuesit e rinj, ndërmarrjet ekzistuese prodhuese, si dhe investitorët potencial nga jashtë. Është e domosdoshme një qasje e re dhe inovative në ndërhyrjet e shtetit dhe të komunës, të cilat do t'i mundësonin bizneseve të zhvillohen në mënyrë më solide dhe me qasje më të mirë në kapital. Prandaj, duhet të ndërhyhet vetëm në fushat në të cilat tregu vetvetiu nuk mund t'i zgjidhë pengesat e tij për zhvillim me qëllim të inkurajimit të zhvillimit të sektorit privat që konsiderohet fundament për këtë shtyllë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2		
Rritja e kapaciteteve egzistuese dhe potenciale të prodhuesve		
1	2	3
Themelimi i zonës së veçant ekonomike për prodhues	Financimi i prodhuesve	Roli vendimmarrës i prodhuesve në të gjitha organet publike

Komuna e Vushtrrisë ka kapacitete të cilat do të mund të e ngritnin sektorin e prodhimit si sektor kyq në komunë. Pozita gjeografike dhe veqantitë e saj mund ta bëjnë komunën atraktive për prodhues të ndryshëm. Komuna mund të tërheq prodhues nga Kosova ashtu edhe nga vendet tjera.

Projektet, aktivitetet dhe programet që do të ndërmerren komuna, në mënyrë që prodhimi të jetë sektor kyq janë:

Themelimi i zonës së veqant ekonomike për prodhues

Komuna e Vushtrrisë është duke ndërtuar zonën ekonomike e cila do të destinohet për të gjitha bizneset. Por në mënyrë që Vushtrria të identifikohet si Zonë e Veqant Ekonomike për Prodhues atherë duhet të inicoj dhe propozoj Qeverisë themelimin e Zonës së Veqant Ekonomike të destinuar për prodhës apo sektorë të veant prodhues.

Ekipi punes ka bërë kërkesë nga AKP që të na vëhen në dispozicion të gjitha tokat e AKP të cilat nuk janë privatizuar ende dhe që mund të jenë të përshtatshme për zonë prodhuese me kushte të veqanta.

Në këtë zonë mund të aplikohen lehtësira si fiskale (kompetencë nacionale), lehtësira në taksa komunale dhe gjithashtu mund të jep tokën në shfrytzim të bizneseve prodhuese me tarifa jashtzakonisht të ulëta.

Në zona të veqanta ekonomike Qeveria e Kosovës mund të vendos norma të veqanta të tatimeve.

Themelimi i Qendrës Trajnuese dhe Inovative

Themelimi i Qendrës trajnuese dhe inovative i mundëson bizneseve prodhuese që të shfrytzojnë hapsirat për trajnimin e punëtorëve potencial për ndërmarrjet e tyre. Gjithashtu në këtë Qendër prodhuesit mund të trajnojnë punëtorët në fusha të ndryshme.

Spektori i inovacionit mund të i shërbej bizneseve për stimulimin dhe nxjerrjen e inovacioneve që mund të i nevojiten ndërmarrjeve të tyre dhe investimeve të reja potenciale nga bizneset prodhuese.

Investimi i Qendrës Trajnuese dhe Inovative bëhet nga komuna e Vushtrrisë apo nga investimeët e huja që komuna mund të i gjej ndërsa me rregullore të veqant rregullohet finacimi i aktivitetëve operative të institucionit nga komuna.

Laboratori I cilësisë dhe prodhimeve ushqimore

Prodhuesit e Vushtrrisë janë shumë të zotë dhe shumë të edukuar. Ata deri më tani kanë ndjekur kurse dhe trajnime profesionale por edhe bazë kanë pas traditën. Nga vizitat studimore e kanë parë shumë të nevojshme që objekti i destinuar për laborator për kontrollin e cilësisë dhe produkteve ushqimore do të mund të i ndihmoj shumë si në hulumtime të ndryshme poashtu edhe në aktivitete të tjera shumë të nevojshme për ata.

Laboratori mund të jetë pjesë e Qendrës Inovative dhe Trajnuese.

Rregullore për kushte privilegjuese për prodhues

Komunës i rekomandohet që të themeloj një rregullore e cila idestinohet kushteve privilegjuese për prodhuesit lokal. Në rregullore të specifikohen fushat ku prodhuesit privilegjoohen si në shfrytëzim të tokës publike, në prokurimet nga komuna (autorizohet Klubi i Prodhuesve si organizat të kryej procedurat në emër të komunës) etj.

Me këtë rregullore gjithashtu duket të specifikohet që bizneset prodhuese të kenë përparësi edhe në zonën ekzistuese.

Financimi i prodhuesve lokal

Komuna e Vushtrisë të harmonizoj të gjitha rregullorët komunale të cilat i influencojnë bizneset, posaqërisht prodhuesit. Gjithashtu të krijoj mundësi të reja të financimit.

Fondi Komunal për përkrahjen e prodhuesve

Komuna e Vushtrisë me një rregullore të veçanta apo me vendim të krijoj një Fond për mbështetje të prodhuesve vushtrrias. Fondi mund të themelohet si fondacion apo mund të ndahet për çdo vit vlerë e caktuar e buxhetit e cila i destinohet bizneseve prodhuese. Ndarja e këtij fondi bëhet sipas kritereve të përcaktuara në vendim apo rregullore.

Projekte dhe aktivitete të tjera në financim:

- a) Të gjitha tatimet e paguara nga prodhuesit të i kthehen dyfish bizneseve përkatse përmes subvencioneve.
- b) Mbështetja financiare në aktivitete promovuese të bizneseve prodhuese
- c) Organizimi i konferencave për prodhuesit në Vushtri.
- d) Broshura informative dhe promovuese për bizneset prodhuese vushtrriase.

Roli vendimmarrës i prodhuesve në të gjitha organet publike

Komuna e Vushtrisë duhet të i krijoj prodhuesve, përmes Klubit të Prodhuesve pjesmarrje aktive në të gjitha organet vendimmarrëse.

Për ta mundësuar këtë përparësi së pari duhet të themelohen disa trupa si:

Këshilli Ekonomik

Në këtë trup prodhuesit duhet të i takoj së paku kryetari dhe sekretari dhe përmes këtij këshilli të themelohet qasja e prodhuesve dhe vendimmarrjen publike⁴.

Grupi Lokal i Veprimit Vicianum

Në parim, grupet lokale të veprimit - GLV, sipas Leader-it i takojnë një familjeje të gjërë të partneriteteve publike-private, të cilët janë bërë instrumente të domosdoshëm për të përballuar numrin e rritur të detyrave publike - nga infrastruktura e rrugëve e deri te shkenca dhe arsimimi. GLV-të janë instrumente për qeverisje lokale apo organe udhëheqëse për zhvillim lokal. Për më tepër, GLV është një hapësirë komunikimi, ku njerëzit zbulojnë dhe shkëmbejnë eksperiencat që i kanë në interesa të fushave të përbashkëta. Grupi Lokal i Veprimit (GLV) “Vicianum” është themeluar në vitin 2009, pas një periudhe dy vjeçare të ndërimit të kapaciteteve dhe mbështetjes direkte nga projekti 'Strategjitë Zhvillimore Lokale' (LDS), projekt ky i financuar nga BE-ja, dhe i menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO) në Kosovë. GLV bazohet në veçoritë kryesore të qasjes LEADER siç janë: 1. Strategjitë zhvillimore lokale “te bazuara në zonën lokale”, 2. Partneritetet publike-private “të quajtura GLV” dhe 3. Qasjes “nga poshtë-lartë” me kompetenca vendimmarrëse për GLV-të të cilat marrin parasysh përpunimin dhe zbatimin e Strategjive Zhvillimore Lokale.

Duke qenë se prodhuesit janë të rëndësishëm së veqant në Vushtrri atëherë pozita e prodhuesve në GLV, posaqërisht në vendimmarrjen e GLV-së duhet të jetë prioritare.

⁴ Këshilli Ekonomik është

S3. Promovimi i prodhuesve të Vushtrrisë në tregun nacional dhe global.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3		
<u>Promovimi i prodhuesve të Vushtrrisë në tregun nacional dhe global.</u>		
1	2	3
Festa-Dita e Prodhuesve	Konferenca vjetore e prodhuesve	Rregullimi ligjor për ekspozimin e prodhimeve lokale në subjektet ekonomike të shitjes

Prodhimet vendore edhe më tej vazhdojnë të përballen me një konkurrencë të ashpër ndaj prodhimeve të importuara të cilat në treg dalin me çmime më të ulëta. Prodhimet vendore janë më cilësore dhe më të sigurta, sepse nuk i nënshtrohen transportit të gjatë e qëndrimit nëpër depo dhe janë të certifikuara me standarde ndërkombëtare. Mirëpo, prodhimeve vendëse po mungon promovimi i duhur i tyre nga ana e shtetit.

Prodhuesit vendorë vazhdimisht kritikojnë ashpër institucionet gjegjëse se nuk po bëjnë asgjë rreth promovimit të produkteve vendëse dhe rëndësisë së konsumimit të tyre në zhvillimin ekonomik të vendit.

Sipas prodhuesve dhe njohësve të çështjes së ekonomisë nëse do të kishte më shumë konsum të produkteve vendore, efekti multiplikativ për ekonominë e Kosovës do të ishte tjetër, ku do t'i kishte dhënë shtytje zhvillimit ekonomik e do ta rriste punësimin.

Ka pasur kampanja prej asociacioneve të bizneseve për promovim të produkteve vendore, dhe qeveria mundohet që në çdo prezantim të saj t'i ketë produktet vendore, mirëpo qytetari ende nuk është i vetëdijshëm se cilat janë aspektet pozitive të konsumit të produkteve vendore.

Komuna e Vushtrrisë duke pas parasysh që ka shumë biznese të njohura prodhuese dhe që njihen në të gjithë Kosovën dhe jasht vendit duhet të e bëjë promovimin e prodhuesve dhe prodhimeve të tyre, së paku në nivel të Kosovës

Dita e prodhuesve vushtrrias-Prishtinë

Duke qenë se të gjitha komunat mundohen të i promovojnë prodhuesit dhe bizneset e tyre përmes diteve dhe aktiviteteve të ndryshme në komunën e tyre, do të ishte mundësi e mirë që Komuna të i promovoj prodhuesit e saj në një ditë të caktuar në një vend të frekuantuar ashtu siq është Sheshi Nënë tereza në Prishtinë.

Promovimi mund të bëhet përmes një panairi në vende të frekuntuara dhe të përcjellet me aktivitete të tjera si:

1. Panairi i prodhimeve vushtrriase i plotsuar edhe me një pjesë të kulturës
2. Konferenca me ekspertë dhe biznese vushtrriase në Prishtinë
3. Dhurimi i pakove me prodhime vendore për qytetarë në nevojë

QAJFEST⁵

Meqenëse Komuna e Vushtrrisë e ka një ditë për promovimin e prodhimeve dhe bizneseve të quajtur si Dita e Patatës, atherë është shumë e nevojshme që një ditë pas saj të themelohet një event që përmban aktivitete të ndryshme promovuese dhe që i kushtohen prodhuesve vushtrrias.

Duke pas parasysh që Vushtrria është e njohur për lokalet që e servojnë qajin si pije tradicionale, mund të tërhiqen shumë vizitor duke i dhënë fokus edhe servimit të vizitorve më qaj.

Projekte dhe aktivitete të tjera që GLV do të jetë bartëse

- Hartimi i profilit të prodhuesve (dokument njoftues)
- Tregu lëvizës
- Aplikimi në grante për prodhues
- Ngritja e profesionistëve të rinjë

⁵ QajFest është event që komuna e organizon rregullisht

- Trajnime dhe sesione informuese lidhur me praktikat bashkohore
- Asistencë për plotësimin e standardeve dhe çertifikim të produkteve vendore

Projekte dhe aktivitete të tjera që GLV do të jetë bartëse

- Hartimi i profilit të prodhuesve (dokument njoftues)
- Tregu lëvizës
- Aplikimi në grante për prodhues
- Ngritja e profesionistëve të rinjë
- Trajnime dhe sesione informuese lidhur me praktikat bashkohore
- Asistencë për plotësimin e standardeve dhe çertifikim të produkteve vendore

Krijimi i qendrës për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe mekanizmave të organizimit të biznesit

OBJEKTIVI SPECIFIK 2		
Krijimi i qendrës për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe mekanizmave të organizimit të biznesit		
1.1	1.2	1.3
Qendra e Biznesit	Qendra Komunale për Zhvillim Ekonomik	Keshilli për Zhvillim Ekonomik

Qendra e Biznesit

Qendra e Biznesit është e formuar përbrenda administratës të Kuvendit Komunal për të përkrahur zhvillimin ekonomik. Punonjësit e kësaj zyre do të ndihmojnë NVM-të dhe

do të koordinojnë projektet komunale, p.sh. ndihma në përgatitjen e të gjithë dokumenteve të nevojshme, eliminimin e pengesave në nivel komunal, në nivele ministrive përkatëse etj. Kjo zyre duhet të punësojë së paku tre punonjës dhe duhet të jetë e pajisur mirë me pajisje TI (Teknologji Informative) si dhe pajisje tjera. Personeli i zyrës duhet të jetë i trajnuar në strategjitë e zhvillimit ekonomik me qëllim që ti takojë nevojat e ekonomisë së tregut. Punëtorët duhet të udhëheqin hulumtime të zbatueshmërisë për secilin projekt komunal sa më parë që është mundur. Pasi të përfundohen vlerësimet teknike dhe hulumtimet financiare, projekti duhet të përkrahet nga kjo zyre me qëllim që të vazhdoj më tutje. Kjo zyre do të përfitonte nga lidhje më të mira të bashkëpunimit me bizneset dhe kompanitë të dhe ato përreth Komunës. Do të funksionojë si një zyre për këshillime ekonomike dhe përfaqësojë kompanitë e suksesshme brenda dhe jashtë Kosovës.

Bartëse e zhvillimit ekonomik lokal do të jetë QZHEL.

Qendra komunale për zhvillim ekonomik

QKZHE është institucion që merret me zhvillimin ekonomik të komunës së Vushtrrisë. Kjo qendër bënë planifikimin, kordinimin dhe implementimin e zhvillimit ekonomik të komunës:

Funksionet kryesore të qendrës përfshirë si:

- organizimin strategjik, vlersimin e ekonomisë lokale, krijimin e strategjise, implementimin dhe evaluimin.
- Kordinon procesin e zhvillimit ekonomik lokal me të gjithë partnerët si, pushteti lokal, qendra e biznesit, qytetarët, shoqëria civile, arsimin etj.
- Angazhon të gjithë akterët në zhvillim ekonomik lokal, krijimin e vendeve të punës, përmirsimin e cilësisë së jetës së qytetarve.
- Planifikon dhe harton projekt-propozime.
- Menaxhon zhvillimin ekonomik lokal.

Përbërja dhe organet QKZHE

Përbërja e QKZHE krijohet ashtu që të gjithë mekanizmat, mjetet, akteret për zhvillim ekonomik të komunes bashkveprojne të kordinuar dhe në një vend.

Përbëhet nga këto mekanizma:

-Administrata e QKZHE (është edhe drejtoria për zhvillim ekonomik lokal)

-Këshilli për zhvillim ekonomik komunal

Administrata e KZHEL

QKZHE duke marrë parasysh që **kordinon dhe angazhon të gjithë akterët (partnerët) komunal në drejtim të zhvillimit ekonomik të komunës së Vushtrrisë** do të ketë një administratë që i përgjigjet këtyre nevojave dhe përgjegjësi.

Administrata përbëhet nga eksperte të fushave të ndryshme (kryesisht ekonomisë) të cilët janë edhe staf të komunës (përfshihen në stafin komunal).

Mundësia më e pranueshme momentale është që filimisht **stafi të angazhohet** nga mbrenda komunës. **Përbërja e kordinatorit** i qendrës për zhvillimit ekonomik i cili duhet të angazhohet nga jashtë.

Përbërja e administratës së QKZHE përbëhet nga profile si:

- 1 kordinator
- 2 ekonomistë (preferohet ekspert të zhvillimit ekonomik lokal dhe biznesit)
- 2 të fushës së bujqësisë dhe blegtorisë
- 1 planifikues
- 1 projekt menaxher

Administrata e qendrës komunale për zhvillim ekonomik **është pjesë e strukturës organizative të komunës së Vushtrrisë.**

Kordinatori i përgjigjet kryetarit të komunës dhe këshillit për zhvillim ekonomik lokal.

Kordinatori i QKZHE ka këto përgjegjësi kryesore:

- Menaxhon me stafin e administratës QKZHE
- Kordinohet me administratën komunale
- Kordinohet me Këshillin për zhvillim ekonomik lokal
- Është përgjegjës për zhvillimin ekonomik të komunës
- I përgjigjet, merrë detyra dhe raporton te kryetari i komunës
- I raporton këshillit ekonomik lokal
- Planifikon dhe menaxhon ZHEL
- Krijon koncepte, projekte dhe programe të LED
- Hulumton dhe tërheq investitorë
- Hulumton fonde dhe donator dhe krijon projekt propozimet në harmoni me kryetarin e komunës dhe KZHEL
- Është pjesë e ekipit menaxhues të komunës

Kordinator zgjedhet me konkurs nga kryetari i komunës i cili është edhe kryetar i këshillit për zhvillim ekonomik lokal, dy antarë nga këshilli për zhvillim ekonomik lokal dhe menaxheri i personalit të komunës dhe një të propozuar nga kryetari i komunës.

Këshilli për zhvillim ekonomik lokal

KZHEL është organi më i lartë i zhvillimit ekonomik të komunës por nuk merrë vendime drejtpërdrejt pasi që kryesisht është organ aprovues dhe miratues për qështje të zhvillimit ekonomik të komunës. Përbërja e KZHEL përfshinë të gjithë partnerët dhe akteret që mund të ndikojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Përkufizimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e KZHEL

1. Këshilli i zhvillimit ekonomik local është organ jo vendim marrës.
2. KZHEL është organ që miraton dhe aprovon të gjitha vendimet, strategjitë dhe planet që kanë të bëjnë me zhvillim ekonomik local, para se të miratohet në Asamblenë Komunale.
3. KZHEL është mekanizëm filtrues i të gjitha vendimeve që kanë të bëjnë me zhvillim ekonomik local.
4. Inicon vendime, projekte, strategji dhe plane për zhvillim ekonomik local.
5. Ndërvepron me Asamblenë Komunale për të gjitha veprimet dhe planet e zhvillimit ekonomik local.
6. Propozon vendime për Asamblenë Komunale.
7. Bashvepron me kryetarin e komunës për zhvillim ekonomik local.
8. Përfaqëson komunën para menakizmave shtetror dhe ndërkombëtar për zhvillim ekonomik local.
9. I mbështet profesionalisht dhe institucionalisht vendimet dhe ndërmarrësit e kryetarit për zhvillim ekonomik local.
10. Organizon mekanizmat e komunës, qeveritare dhe joqeveritare në drejtim të zhvillimit ekonomik local.

Përbërja e KZHEL

1. Kryetari i Komunës i cili është edhe kryetar i KZHEL.
2. 6 përfaqësues nga komuniteti i biznesit të cilët propozohen nga Qendra e Biznesit dhe të cilët përfqësojnë fuqi ekonomike. Prioritet kanë biznismenët duke filluar nga më i suksesshmi.
3. Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
4. Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Bujqësi
5. 2 të deleguar nga Qendra e Biznesit
6. 2 përfaqësues nga sektori i bujqësisë. Preferohen të mos jenë nga komuna.
7. 1 nga lëmia e urbanizmit
8. 2 të deleguar nga mekanizmat e shoqërisë civile.

9. 1 nga lëmia e arsimit. Preferohet të mos jetë nga komuna.
10. 2 që përfaqësojnë vlera dhe që nuk janë të përfshirë në këta mekanizma.

Meqense strategjia e zhvillimit ekonomik lokal të komunës së Vushtrisë ka objektiva strategjike zhvillimi i bujqësisë, përmirsimi i klinës biznesore, atëherë preferohet që nga drejtime të ndryshme të propozohen nga një person nga tre objektivat strategjike.

Shërbime të përshtatshme one stop shop, online dhe telefon

Qendra për Përkrahjen e Biznesit gjithashtu do ti ndihmojë bizneset dhe ndërmarrësit që u nevojitet ndihmë me procedurat ligjore: juridike, ekonomike në Ministrinë përkatëse, etj. Procedurat për fillimin dhe funksionimin e biznesit janë duke u thjeshtësuar por duhet të thjeshtohen edhe më që mos të jenë aspak të komplikuar dhe të marrin kohë jashtë mase.

Qendra e biznesit ka hapsirë të përshtatshme që shërbimet e biznesit të përsosen dhe të jepen sipas kërkesave të komunitetit të biznesit, mbrenda kornizave ligjore. Kjo qendër do ti mundesoj që shumicën e shërbimeve bizneset ti marrin one stop shop, online dhe përmes porosisë të cilën e bëjnë përmes telefonit. Këto shërbime do të duhej të ariheshin sidomos nga klinetët e privilegjuar.

Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues të komunës

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4		
Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues të komunës		
3.1	3.2	3.3
Aktivizimi i zonës aktuale	Ndërtimi i zonës së veçant prodhuese për tërheqjen e investimeve të huaja	Kapacitetet mbështetëse

Aktivizimi i zonës aktuale

Komuna e Vushtrrisë është në ndërtim e sipër të zonës industriale me sipërfaqë rreth 14 ha. Përderisa kjo zonë në proces Komuna e Vushtrrisë, specifiku është Drejtoria për zhvillim ekonomik dhe bujqësi mund të fillojë me ndërtimin e kapaciteteve teknike për menaxhimin e zonës dhe tërheqjen e investitorëve.

Duke u bazuar në studimin e fizibilitetit të zonës, fillimisht mund të targetohen bizneset që do të alokohen në zonë. Është shumë e rëndësishme që bizneset ekzistuese të konsultohen fillimisht për nevojat dhe kapacitetet e tyre për vendosjen në zonë industriale duke pas parasysh që ato janë bartëse të nivelit të deritashëm i zhvillimit ekonomik lokal.

VENDOSE NJË PLAN TË ZONËS!

Zona e veçant prodhuese për tërheqjen e investimeve të huaja

Zona prodhuese është e sqaruar më gjerësisht në Qëllimin 1 për përkrahjen e prodhuesve të komunës së Vushtrrisë. Kjo zonë është e propozuar nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë z. Xhafer Tahiri. Qëllimi i kryetarit është që përveç që të zhvillohet një zonë e veçant prodhuese e krijuar me vendimet e Qeverisë së Kosovës ku prodhuesit kanë lehtësira edhe fiskale të lejuara nga Qeveria, të shfrytëzohet edhe për tërheqjen e investitorëve të jashtëm, qëllimi i investimit të të cilëve është prodhimi në vendim tonë.

Themelimi i qendrës trajnuese dhe inovative (QTI)

Themelimi i Qendrës trajnuese dhe inovative i mundëson bizneseve prodhuese që të shfrytëzojnë hapsirat për trajnimin e punëtorëve potencial për ndërmarrjet e tyre. Gjithashtu në këtë Qendër prodhuesit mund të trajnojnë punëtorët në fusha të ndryshme.

Sektori i inovacionit mund të i shërbej bizneseve për stimulimin dhe nxjerrjen e inovacioneve që mund të i nevojiten ndërmarrjeve të tyre dhe investimeve të reja potencioale nga bizneset prodhuese.

Investimi i Qendrës Trajnuese dhe Inovative bëhet nga komuna e Vushtrrisë apo nga investimeët e huja që komuna mund të i gjej ndërsa me rregullore të veqant rregullohet finacimi i aktiviteteve operative të institucionit nga komuna.

Qendra promovuese

Qendra promovuese apo “Porta e Zonës industriale dhe e ekonomisë lokale” është hapsirë e përshtatshme për promovim ku bizneset në zonë industriale dhe bizneset tjera lokale mund ti promovojnë produktet dhe shërbimet e tyre. Kjo qendër përbëhet nga zyra të vogla për promovim (të përshtatshme për promovim) ku bizneset mund ta kenë edhe përfaqësuesin e tyre, kontaktet dhe produktet. Hapsirat mund të jenë të përshtatshme edhe vetëm për promovim të produkteve dhe të kenë edhe kontaktet.

Inkubatori

Përbëhet nga hapsira të përshtatshme dhe të adaptueshme lehtë, fleksibile të cilat shërbejnë për investitorët potencial. Koha për dhënjë në shfrytëzim nuk mund të jetë më shumë se tre vjet përveq në raste specifike (psh kur lëhet në shfrytëzim të fondeve apo partnerëve për zhvillim ekonomik). Zyrat duhet të jenë të paisura me telefon, internet etj dhe kryesisht i jepen në shfrytëzim investitorve potencial të cilët nu kanë vend për administratat e tyre deri sa ti përfundojnë investimet e tyre.

Shfrytëzimi i Kapitalit Ekzistues të Komunës

Me kapitali komunal nënkuptojmë resurse natyrore dhe njerëzore sikurse:

- a) Toka që është pronë e Komunës
- b) Godinat që mund të përdorën për qëllime të biznesit

- c) Infrastruktura: rryma, uji, mbeturinat, shkollat, objektet për kujdes shëndetësor, etj
- d) Punëtorët e kualifikuar, ekspertët nga Komuna
- e) Prodhimin e energjisë nga era

Për të iniciuar zhvillimin e ndërmarrjeve dhe bizneseve të reja ose të zgjeruara, kapitali i kontrolluar nga Komuna duhet të jetë në dispozicion. Pronarët e bizneseve do të përfitonin nga përdorimi në ngritje i këtij kapitali, sikurse që do të rritej numri i punëtorëve të punësuar në këto biznese. Në përgjithësi, qasja më e lehtë e kapitalit komunal do të përmirësojë kualitetin e jetës.

Rregulloret komunale për stimulimin e biznesit dhe krijimi i fondeve për përkrahjen e bizneseve

Q4		
Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues të komunës		
4.1	4.2	4.3
Rregulloret komunale për përkrahjen e bizneseve	Fondi për zhvillim lokal	Fondi për garancitë kreditore të mikrobizneseve

Tregu i ekonomisë lejon investimet, edhe nëse biznesi nuk ka gjasa për sukses. Komuna mund të ndihmojë në parandalimin e investimeve të gabuara dhe do të ishte mbrojtjes së bizneseve ekzistuese. Për shembull, nëse ekziston një numër i madh i pompave të karburanteve, Komuna mund të refuzojë lejen për ndërtim nëse nuk i përmbush kushtet

e ndryshme për biznes siç janë rregullat e planifikimit urban, përcaktimi i tokës nga bujqësore në atë për ndërtim, standardet e mbrojtjes së ambientit, etj. Në anën tjetër, aktivitet që janë të orientuara në prodhimtari do të jetë një prioritet i lartë dhe rregulloret mund të zhvillohen për të stimuluar formimin e bizneseve te reja përderisa i mbron bizneset ekzistuese.

Rregullorët që komuna duhet të i nxjerrë janë:

- Rregullore për përkrahjen e bizneseve (përfshihen kushtet dhe kritret, si psh punëtorët e rinjë i financohet 50% e pagës);
- Rregullore për përkrahjen e prodhuesve;
- Rregullore për krijimin e fondit për zhvillim ekonomik lokal (mund të krijohet si fondacion i jashtëm);
- Fondi për garanci kreditore;

S2. Zhvillimi i bujqësisë

Vushtrria ka traditë në kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, veqanërisht në perimtari dhe pemtari. Kultivimi i patates e ka bërë Vushtrrinë rajon të veçant dhe të njohur andaj Vushtrria identifikohet me pataten. Patatja i ka dhënë identitetin të veçant edhe Festës së Komunës. Duke qenë se kultivimi i kulturave bujqësore në Vushtrri bëhet edhe për qëllime industriale është shumë e nevojshme që bujqësia si degë e ekonomisë të zhvillohet edhe më tutje. Komuna i ka dhënë rëndësi bujqësisë vazhdimisht andaj edhe bujqësia si degë e ekonomisë është përfshirë mbrenda drejtorisë për zhvillim ekonomik lokal.

PRIORITETI STRATEGJIK 1I

ZHVILLIMI I BUJQËSISË

Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4
Krijimi i Oazave Bujqësore	Mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore	Sigurojë përgatitje profesionale dhe stimulim të bujqësisë	Zhvillimi i GLV-së dhe krijimi i kooperativave

Krijimi i oazave bujqësore

Edhe pse bujqësia ka avancim, toka bujqësore në Vuishttri ende nuk shfrytëzohet në masë. Një nga faktorët të cilët e pamundësojnë shfryzimin e tokave bujqësore është fragmentimi i tokave deri në sipërfaqe shumë të vogla të cilat janë shkaktuar nga tradita e ndarjes së tokës si rrjedhojë e ndarjeve të familjeve të medha, përderisa toka ka qenë burim kryesor i jetesës.

Me qëllim të krijimit të tokave më të medha bujqësore të cilat mund të shfrytëzohen për zhvillimin e bujqësisë, komuna duhet të identifikoj tokat potenciale të cilat mund të merren në shfrytëzim afatgjatë nga fermerët e vegjël dhe të i jep në shfrytëzim për fermerët serioz të cilët ndikojnë në zhvillimin e kultivimit të kulturave të veqanta. Sasia sipërfaqës së tokës që krijohet mundëson që të krijohen agrobiznese rentabile dhe të qëndrueshme pasi që në sipërfaqe të vogla shpenzimet kanë përqindje të lartë , shpesh më të larta se të hyrat që krijohen.

Mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore

Komuna ka zhvilluar qëllimet në vazhdim për të përkrahur zhvillimin bujqësor:

- a) Aplikimi i ligjit mbi mbrojtjen e tokës bujqësore . Ndryshimi në shëndrrimin nga toka bujqësore në tokë ndërtimore mund të bëhet vetëm duke e aplikuar ligjet e aplikueshme.
- b) Tatimi i djerrinave në kuadër të tatimit në pronë mund të i ndihmoj komunës që tokat bujqësore të punohen duke qenë se të papunuara kanë taksë më të lartë. Ministria e Bujqësisë duhet së shpejti do të qarkullojë udhëzime administrative për tatimin mbi djerrina. Këto udhëzime do ti regjistrojnë të pronat e fermerëve dhe do ti vlerësojnë tatimet me qëllim që të inkurajojnë shfrytëzimin produktiv të tokës bujqësore.
- c) Shfrytëzimi i drejtë i tokës bujqësore. Planet e Komunës për të rritur numrin e sipërfaqeve me vreshtari, pemë, dhe pyje, sikurse në vazhdim:

- Rritja e perimtarisë për 50 hektarë. Ky projekt do të përfshinte shumë fshatra dhe një numër të konsiderueshëm të fermerëve.
- Rritja e sipërfaqeve me pemë për 50 hektarë. Një numër i madh i fshatrave do të përfshihej. Kushtet klimatike janë të përshtatshme për këtë aktivitet. Pemët sezonale të verës si dhe ato të vjeshtës-dimrit do të siguronin një furnizim të rregullt të tregut me fruta si dhe fruta për përpunim.
- Pyllëzimi është prioritet për të mbrojtur sipërfaqet që janë të kanosur nga erozioni si dhe ti pyllëzoj ato sipërfaqe që kanë pasur prerje masive të drunjtëve.

Aplikimi i Teknologjisë Moderne

Komuna do të vazhdojë të hulumtojë për kushtet të volitshme të kredive që janë të përshtatshme për fermerët. Teknologjitë moderne bujqësore, sikurse serrat, do të rrisin prodhimtarinë, do të ruanin strukturën e tokës, do të zvogëlojnë shpenzimet, rrisin efikasitetin, dhe sigurojnë një furnizim të vazhdueshëm të tregut me prodhime vendore.

Përfshirja e varieteteve të reja të perimeve dhe përmirësimi racor në blegtori

- a) Ministria e Bujqësisë ka financuar fusha eksperimentale për mbjelljen e drithërave, grurit, sojës, pemëve dhe perimeve. Analizimi i këtyre fushave ka rritur prodhimtarinë. Andaj, Komuna do të inkurajoj fermerët për të vazhduar me këto varietete të farërave dhe do të përfshijë këto varietete në listën Kombëtare të farërave.
- b) Komuna do të propozojë projekte për të shtimin e fondit të bagëtisë për të përmirësuar strukturën racave të gjedhëve/lopëve..

Përgatitja Profesionale dhe Stimulimi i Fermerëve

Komuna e Vushtrrisë ka investuar vazhdimisht në bujqësi por fatkëqësisht në vlera të vogla nga që mundësitë buxhetore të komunës janë të kufizuara. Megjithatë në vitet në vijim komuna duhet të rrisë fondin për bujqësi dhe të i mbështes fermerët në shumë fusha.

- a) Organizimi i panaiereve të ndryshme dhe pjesëmarrja në panaiet vendore dhe në panaiet jashtë vendit

- b) Kultivimi i fushave testuese eksperimentale me kultura të ndryshme të farave të reja
- c) Vizita të rregullta të fermerëve
- d) Administron analizën e tokës përgjatë tërë territorit të Komunës
- e) Organizimi i seminare të ndryshme
- f) Ndihmon në formimin e shoqatave të ndryshme bujqësore
- g) Përfitim i përvojave bujqësore nga shtetet tjera
- h) Angazhon staf profesional
- i) Përgatit fletushka të ndryshme bujqësore për shpërndarje tek fermerët

Aktivizimi i GLV Vicianum dhe krijimi i kooperativave

Përkrahja dhe zhvillimi i zonave rurale po bëhet nëpërmjet shumë formave, të cilat deri më tash janë treguar mjaft të suksesshme. Përveç përkrahjes së drejtpërdrejt të fermerëve, institucionet vendore po përkrahin edhe realizimin e shumë projekteve, me Grupet Lokale të Veprimit (GLV), nëpër komuna.

Realizimi i projekteve me këto grupe ka filluar të realizohet që nga viti 2009, në partneritet me komunat dhe Ministrinë e Bujqësisë. Qëllimi i këtyre grupeve, përveç përkrahjes së fermerëve është edhe rregullimi i infrastrukturës dhe realizimi i projekteve të ndryshme që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së banorëve në zonat rurale.

GLV Vicianum konsiderohet passive për më shumë se dy vite pasi që kanë konsideruar që kushtet e Ministrisë së Bujqësisë janë shumë të pavaforshme për funksionimin e saj. Me gjithatë në Kosovë ka disa stori të suksesit të cilat sot janë bartëse të zhvillimit rural në komuna. GLV mund të kryej edhe funksionin e kooperativave bujqësore me shumë suksese të cilat funksionojnë me koncepte bashkëkohore dhe sit ë tilla i ndihmojnë fermerët në mënyra të ndryshme duke filluar nga sigurimi i tregut dhe planifikimi i mbjelljeve, në mbështetjen profesionale dhe teknike, në sigurimin e farave dhe fidaneve e deri në gjetjen e finacimeve dhe implementimin e projeteve të ndryshme.

Çfarë është GLV dhe koncepti LEADER

LEADER = Liaison Entre Actions de Développement de l' Economie
Rurale
(Lidhjet mes ekonomisë rurale dhe veprimeve zhvillimore)

ZhERR dhe programi LEADER

Zhvillimi ekonomik rural rajonal është faktor kryesor i avancimit ekonomik të BE-së. Gjatë viteve të kaluara, ZhERR “e zbuloi” shumë e më shumë perspektivën rajonale në zhvillimi

n rural. Andaj, programi LEADER i BE-së është një nga programet më të njohura për përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale. Programi LEADER e ofron kornizën për qasjen specifike LEADER. Ideja e LEADER ishte identifikimi i energjisë, resurseve njerëzore dhe i institucioneve që mund t'i kontribuojnë procesit të zhvillimit rural përmes formimit të partneriteteve në nivel nënrajonal mes sektorit publik, privat dhe atij civil. Qasja LEADER ndërlidhet me fuqizim lokal përmes zhvillimit të strategjisë lokale dhe ndarjes së resurseve. Element kryesor për zhvillimin e një zone specifike dhe përfshirjen e përfaqësuesve lokalë në procese të vendimmarrjes është Grupi Lokal i Veprimit (GLV).

Programi LEADER – një histori e shkurtë

BE-ja e prezantoi programin LEADER në vitin 1991. Karakteri i ri dhe inovativ i kësaj qasjeje ishte ideja për një qasje territoriale, të integruar dhe pjesëmarrëse. Në fazën e parë LEADER (LEADER I, 1991-1993) u theksuan zonat rurale në gjendje të pafavorshme dhe u përfshinë 217 rajone. Ajo ishte fazë eksperimentale, e cila ishte vazhduar në LEADER II, 1994-1999. Atëbotë, aspekti inovativ për projekte u bë më i rëndësishëm. Duke u bazuar në rezultatet e suksesshme të qasjes LEADER në fazën e radhës (LEADER+, 2000- 2006), programi atëherë i mbuloi të gjitha llojet e zonave rurale brenda BE-së. Gjatë viteve 2007- 2013, programi tërësisht u integrua. Kjo nënkupton se ai ishte pjesë përbërëse e politikës së BE.

LEADER EVOLUTION...

LEADER = **L**iaison **E**ntre **A**ctions de **D**éveloppement de l'**É**conomie **R**urale
(Links between the rural economy and development actions)

LAG = **L**ocal **A**ction **G**roup

LDS = **L**ocal **D**evelopment **S**trategy




Figura: Zhvillimi i konceptit LEADER në BE

Përse LEADER në Kosovë?

Republika e Kosovës ende nuk është vend anëtar i Bashkimit Evropian, pra pse të flitet për programin për zhvillim rural, në të cilin shteti nuk ka qasje të drejtpërdrejtë? Prapa programit LEADER me mjetet financiare qëndron qasja specifike LEADER e miratuar në BE me zonat e saj rurale të ndryshme. Andaj kjo nuk vlen vetëm për rajonet e BE-së, por edhe për rajonet e tjera rurale, siç është Kosova. Kosova aktualisht është duke kaluar nëpër procesin e përafrimit me Bashkimin Evropian, dhe e ka statusin e ‘kandidatit potencial’. Kështu që duhet të themelohen strukturat për zbatimin e

programeve dhe standardeve të BE-së. Një përzgjedhje e përparësive tregon për përfitimin shtesë të qasjes LEADER për zonat rurale në Kosovë:

- Qasja LEADER e mbështetë identifikimin e potencialeve lokale dhe rajonale në zona specifike.
- I ndihmon rajoneve (të varfra) rurale që të bashkëpunojnë dhe të zbatojnë projekte të përbashkëta;
- Ndhmon për motivimin e banorëve lokalë për t'u angazhuar për zonat e vendeve të tyre;
- Ndhmon për krijimin e vetëdijesimit të shtuar dhe perspektivave më të mira për banorët e zonave rurale.

Synimi i përgjithshëm i të gjitha përpjekjeve është përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët e zonave rurale. Cilësia e jetës nuk mund të nënkuptohet vetëm në aspektin e zhvillimit ekonomik. Ajo po ashtu nënkupton vlerësimin e trashëgimisë kulturore, mbështetjen e strukturave sociale apo ruajtjen e biodiversitetit në zonat rurale. Qëllimi është që banorëve të zonave rurale t'u jepet perspektiva për t'ua mundësuar qëndrimin nëpër rajonet e veta dhe fuqizimi i identitetit të banorëve në ato rajone.

Shtatë tiparet kyçe të programit LEADER

Për shmangien e keqkuptimeve: LEADER nuk është program për t'i mbështetur vetëm bujqësinë apo fermerët. Ai është program për fuqizimin dhe zhvillimin e zonave rurale me të gjithë aktorët dhe iniciativat e tyre. Andaj, mund të zbatohet një varg i gjerë i projekteve të ndryshme. Të gjithë kanë për qëllim mbështetjen e zonave rurale. Kjo mbështetje realizohet në turizëm, kulturë, në ekonominë rurale si dhe në temat sociale. LEADER karakterizohet nga shtatë tipare kyçe:

Strategjitë Zhvillimore Lokale të bazuara në zonë

Rajoni LEADER apo GLV duhet të përkufizohet me kufij të qartë. Përkufizimi i zonës bëhet nga vet personat e rajonit. Kjo nënkupton se kufijtë jo domosdoshmërisht janë përgjatë kufijve administrativë aktualë, por se ata mund t'i kenë format e veta. Shpeshherë kjo formë përkufizohet me tipare natyrore, historike apo kulturore. Ky është

fakt i rëndësishëm meqë përkufizimi vetanak i rajonit LEADER e shpreh shumë mirë qasjen e programit të bazuar në zonë. Ndryshe nga programet e tjera që merren me vetëm një temë kryesore, për shembull çështjet sociale, ekologjinë, apo bujqësinë, qasja e bazuar në zonë u përgjigjet të gjitha temave të cilat janë relevante për ndonjë rajon specifik. Andaj, kjo qasje mund të quhet qasje e ndërthurtë. Kjo nënkupton se tema të ndryshme trajtohen ndarazi, por në mënyrë të integruar dhe të ndërlidhur.

Partneritetet lokale publiko-private: Grupet Lokale të Veprimit

Grupet lokale të veprimit e mbulojnë një zonë të përcaktuar, ku anëtarët e tyre vijnë si nga sektori privat ashtu edhe nga ai publik. Ndryshe nga programet apo organizatat e tjera, vendimet në lidhje me strategjinë dhe projektet zhvillimore nuk vijnë nga hierarkia administrative apo politikanët, por nga banorët e rajonit të GLV-së. Ky është partneritet ku merren parasysh përfaqësuesit e zgjedhur demokratikë, në njërën anë, si dhe nevojat e idetë e banorëve lokalë, në anën tjetër. Kjo pjesëmarrje e palëve rajonale të interesit është një parim i punës me qasjen LEADER, që ndërkohë është miratuar edhe nga institucione dhe programe të tjera, jo vetëm në BE, por edhe në nivel kombëtar.

Qasja nga poshtë-lartë

Përfshirja e akterëve dhe institucioneve lokale në zhvillimin rural regjional është thelbësore për metodën LEADER. Banorët ruralë shihen si ekspertë në rajonin e tyre në lidhje me shqetësimet e tyre në ekonomi, çështje sociale, identitet, ekologji dhe kështu me radhë.

Veprimet e integruara dhe shumësektoriale

Strategjia Zhvillimore Lokale ka karakter integruar dhe të ndërthurtë. Kjo nënkupton sfidën e opinioneve dhe interesave të ndryshme. GLV-ja nga ana tjetër ka për detyrë gjetjen e konsensusit mes partnerëve, interesave dhe sektorëve të ndryshëm me qëllim të përzgjedhjes dhe zbatimit të projekteve më të përshtatshme për rajonin. Fushat e ndryshme të veprimit (p.sh. demografia, mjedisi, kultura, etj.) dhe projektet duhet të lidhen. Kjo e shpreh qasjen e ndërthurtë, dhe njëkohësisht tregon për varësitë prapa gjërave ashtu siç janë në realitet. Në praktikë mund të krijohen situata ku të dyja palët janë fituese apo sinergji ku të gjithë partnerët mund të përfitojnë.

"Pragu i ultë dhe financimi i orientuar prej kërkesave u mundëson akterëve të ri që të përfitojnë dhe të bëhen kontribues aktivë për zhvillim lokal. Të rinjtë, femrat, vullnetarët, të papunët dhe grupet e tjera që janë në disavantazh fitojnë qasje në mbështetje dhe financim, qasje e cila nuk do të ekzistonte po qe se ata do të vareshin vetëm nga programet ekzistuese." (Lukesch & Schuh)

Inovacioni

Inovacioni është i rëndësishëm për metodën LEADER. Kjo nuk do të thotë se GLV-ja duhet të shpikë diçka të re. Me inovacion nënkuptohet zbatimi i një qasjeje, një projekti apo produkt i cili është i ri për rajonin që e mbulon GLV-ja. Bordi vendimmarrës i GLV-së duhet të bindet për projekte inovative meqë gjithnjë ka pasiguri nëse idetë e reja bartin ndonjë rrezik. Inovacionet kanë potencialin e mbështetjes së zhvillimit të rajonit.

Bashkëpunimi

Vet GLV dëshmon se çka mund të arrihet me bashkëpunim mes palëve lokale të interesit. Bashkëpunimi po ashtu është mjet për të mësuar prej të tjerëve apo prej rajoneve të tjera. Andaj, GLV-të duhet gjithnjë të jenë të hapura për bashkëpunim me të tjerët, qofshin edhe nga shtetet e tjera (*bashkëpunimi ndërkombëtar*).

Rrjetëzimi

Rrjetëzimi është parim kryesor i punës së GLV-ve. GLV-të mund të konsiderohen si rrjet lokal. Megjithatë, rrjetëzimi duhet të ketë fushëveprim më të gjerë. Jo vetëm brenda dhe përmes GLV-së në rajon, por ai duhet të praktikohet edhe me GLV-të e tjera, rajonet e tjera rurale, institucionet e tjera, e kështu me radhë. Kjo u ndihmon GLV-ve që të mësojnë nga të tjerët

S3. Zhvillimi i jetës kulturore dhe turizmit

Vushtrria është qytet i lashtë, por edhe modern, i cili ndodhet në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Vushtrria e sotme më herët është quajtur [Vician](#) apo siç njihet në burimet latine: Vicianum.

Ndërtimet e bëra mbas luftës Vushtrrinë e bëjnë një qytet tepër tërheqës, si për t'u vizituar, ashtu edhe për të investuar në këtë qytet, që për disa shekuj ka qenë qyteti më i madh i Kosovës, por edhe ndër qytetet më të mëdha të Ballkanit dhe fatmirësisht, pas luftës, ky qytet antik me vlera të jashtëzakonshme e ka marrë prapë shkëlqimin e dikurshëm. Faktin që Vushtrria është qytet kulturor e vërtetojnë edhe disa monumente që ndodhen në këtë qytet, si: Ura e gurit, hamami i qytetit, kështjella (Kalaja) e Vushtrrisë, çezmja e qytetit, Xhamitë disa shekullore, shtëpitë e vjetra, rrugët me kalldrëm, varrezat myslimane, etj

SYNIMI STRATEGJIK 3

ZHVILLIM I JETËS KULTURORE DHE TURIZMIT

OS 1	OS 2	OS 3
VicianumFest	Vushtrria qendër historike	Zhvillimi i turizmit kulturor, rural dhe sportiv

Vushtrria është një vend i lashtë, që daton më herët se [Perandoria Romake](#), përkatësisht që nga koha e Dardanëve. Në kohën e Perandorisë Romake ka patur një stacion me emrin [Vitianum](#), siç e dëshmon edhe mbishkrimi i gjetur në rrethin e Kumanovës, që konsiderohet shenjë e kahjes së rrugës për në Vicianë.^[4]

Në fund të shekullit I para Krishtit, Vicianë pushtohet nga Perandoria Romake. Gjatë periudhës së pushtimit romak (I-V), Vicianë kishte arritur një zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe kulturor.

Në vitin 395, pas shkatërrimit të Perandorisë Romake, Vicianë mbeti në kuadër të Bizantit.

Ndërkaq fiset turke dhe sllave që erdhën në Ballkan në shekullin VI-VII, e shkatërruan këtë gadishull dhe toponimet e vjetra pellazgo-ilire ua përshtatën gjuhëve të tyre.

Në mesjetë Vicianë shënohej me emrin VIÇITRINA (Trina e viçave), ndërsa sllavët këtë emër e sllavizuan duke e quajtur "VUÇITRN".

Në shekujt II-III, në Vicianë dominonte Krishtërimi, ndërsa pas ndarjes së krishtërimin më 1054 në katolicizëm dhe ortodoksi, pjesa më e madhe e popullatës së Vicianës ishte katolike.



Figura: Ura e Gurit, Vushtrri

Në shekullin XIV, Perandoria Osmane filloi ta pushtonte Ballkanin. Në Vushtrri prezenca e osmanëve shënohet fillimisht në vitin 1439, ndërsa përfundimisht u pushtua në vitin 1455. Vendosja e administratës osmane në Vushtrri bëri që në këtë qytet të përhapet feja islame dhe të ndërtohen xhami, hane, medrese, hamame etj.

Gjatë shekujve XV-XVIII, Vushtrria ishte ndër qytetet më të mëdha në Ballkan dhe në Perandorinë Osmane dhe qendër e sanxhakut më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane.

Duke u mbështetur në këto karakteristika Vushtrria duket të merrë tipare specifike të cilat e dallojnë nga komunat tjera në Kosovë.

VicianumFest

Komuna e Vushtrrisë ka disa ngjarje komunale por nuk ka ende një rregullore e cila e rregullon festën e komunës. Rekomandohet që Komuna të nxjerrë një rregullore e cila e përcakton një javë si festë të Komunës e cila propozohet të quhet “VICIANUMFEST”.

Në VicianumFest përmbledhen ngjarjet kryesore të komunës dhe ftohen të gjithë akterët të cilat janë të rëndësishëm për komunën.

Në çdo vit krijohet një grup punës që i përcakton eventet dhe agjendën e Vicianum Fest.

Shpallja e Vushtrrisë si Kryeqytet Historik

Disa nga qytetet e Kosovës kanë filluar të marrin tretmanin e kryeqytetit të veçant duke u mbështetur në specifikat e veta si Prizreni kryeqytet Kulturor.

Duke filluar nga vendimi i Kuvendit Komunal për shpalljen e Vushtrrisë si Kryeqytet Historik, administrata komunale duhet të i ndjek disa hapa tjerë për jetëzimin e këtij projekti që Vushtrrisë i jep tretman të veçant.

Komuna duhet të inicoj hartimin e një projekt propozimi i cili jep hapat e qart se çfarë duhet të ndërmerret dhe si duhet të bëhet Vushtria Kryeqytet Historik. Disa nga hapat janë si më posht:

- Vendimi i Kryetarit për shpalljen e Vushtrrisë Kryeqytet Historik;
- Miratimi në në Kuvendin Komunal i vendimit të shpalljes së Vushtrrisë Kryeqytet Historik;
- Kërkesa e Komunës për Agjensionin e Monumenteve Kulturore që të inicoj ligj të veçant;
- Identifikimi i institucioneve të Qeverisë së Kosovës që mund të zhvendosen në Vushtri;
- Fillimi i zhvendosjes së një pjesë të institucioneve qendrore të kulturës në Vushtri;

Zhvillimi i Turizmit në Vushtri

Si formë e rëndësishme e zhvillimit të turizmit modern duke pas në fokus zhvillimin afatgjatë të zonës rurale në kuadër të kësaj strategjie është konceptuar një projekt me impakt të gjerë të zhvillimit të turizmit që plotëson nevojat e turistëve të pranishëm dhe rajonin pritës duke mbrojtur dhe rritur mundësi të zhvillimit socio ekonomik në të ardhmen.

Turizmi rural apo ekoturizmi fokusohet dhe merr pjesë në mënyrë aktive në pjesët rurale. Shumë fshatra rurale në Vushtrri janë mikpritës dhe të etur për të mirëpritur dhe përqafuar idenë e zhvillimit të turizmit në mënyrë afatgjatë.

- Licencimi i familjeve mikpritëse në zonat rurale
- Krijimi i kushteve për investime në bio-turizëm
- Krijimi i guidës turistike një javore ku do të përfshihen vizita të objekteve historike dhe kulturore, qëndrimit në familje bujqësore dhe blegtorale, pjesmarrjes së turistëve në prodhim dhe përpunim të produkteve
- Krijimi i Komitetit (Këshillit) Turistik për zhvillimin e turizmit
-

Projektet specifike

Ndërtimi Haneve

Për ti dhënë Vushtrrisë tretman të veçant dhe për ta identifikuar me të kaluarën e ndrutir të saj Vushtrria duhet të shpall thirrje për investime privao-publike për ndërtimin e Haneve si objekte hoteliere.

Hanet mund të tërheqin vizitor të cilëve përveq akomodimit në hane i afrohet edhe një guidë disaditore në Vushtrri dhe komunat përreth.

Licencimi i ciceronëve

Pronarët e haneve mund të licencohen edhe për cieronë që përveq biznesit të akomodimit dhe ushqimit ata mund të i udhëzojnë turistët për guidat turistike që përfshijnë muumentet turistike në Vushtri dhe vende në komunat përreth saj.

Maratona “Vrapojmë me Prodhuesit Vendor”

Duke qenë se Vushtrria ka një afërsi me Prishtinën mund të organizoj një maratonë në përkrahje të prodhuesve vendor. Maratona do të udhëhiqet nga prodhuesit vendor dhe pjemarrësit do të identifikohen me një nga prodhimet vendore, mundësisht Vushtrriase. Maratona organizohet nën patronatin e kryetarit të Komunës së Vushtrrisë në bashkëpunim me organizatat e prodhuesve vendor dhe prodhues Vushtrrias

Zhvillimi i kapaciteteve prodhuese të energjisë së ripërtëritshme dhe mineralogjisë

Komuna e Vushtrrisë ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të zhvilluar kapacitete të energjisë së ripërtëritshme. Në kuadër të kësaj Komuna ka bërë hulumtime për tërheqjen e investitorve potencial për të investuar në prodhimin e energjisë me erë dhe gjithashtu ka disa projekt ide për të krijuar liqene akumuluese në të cilët mund të zhvillohen edhe kapacitete për prodhimin e energjisë me ujë.

SYNIMI STRATEGJIK 4	
ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PRODHUESE TË ENERGIJË SË RIPËRTRITSHME DHE MINERALOGJISË	
OS 3.1	OS 3.2
Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme	Krijimi i vendeve të punës në mineralogji

Aktivitetet që Komuna duhet të i ndërmerrë për arritjen e kësaj objektivë janë:

- Identifikimi i kapaciteteve për energjinë me erë;
- Identifikimi i burimeve të mundshme të energjisë së ripërtëritshme;
- Identifikimi i pasurive natyrore dhe mineraleve;
- Hartimi i profilit të kapaciteteve të mësipërme;
- Hulumtimi për investitor potencial;
- Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe me KIESA për investitorë strategjik;
- Asistenca teknike e investitorve potencial;

SPECIFIKIMI I NEVOJAVE PËR PROJEKT PROPOZIM

Para çdo projekt propozimi komuna do të përgatitë deklaratën e nevojave për projekt propozimin. Pasi që komuna nuk ka një dokument identifikues për komunën atëherë është shumë e nevojshme që të krijohet profili i komunitetit me seksionin e veçant për prodhues apo së paku profili i prodhuesve. Me posht do të paraqitet deklarata e nevojave për profilin e prodhuesve. Në shtojcën 2 do të paraqitet Deklarata e nevojave për Profilin e Komunitetit.

PLANET PËR VEPRIM⁶

Pas përzgjedhjes së projekteve më prioritare, komuniteti i ka identifikuar grupet e interesit për të krijuar ekipin për veprim. Këto ekipe veprimi kanë përgatitur planet paraprake për veprim. Projektet prioritare do të zhvillohen në projekt propozime.

Plani i Veprimit – identifikimi dhe hartimi i profilit të bizneseve dhe prodhuesve

Tabela 5 –Plani për Veprim për Profilin e Bizneseve— Komuna e Vushtrrisë

Emri i aktivitetit	Aplikuar nga	Përkrahur nga	Data fillimit	e Data përfundimit	Rezultatet e pritura	Komentet
Përgatitja e një projekt	Administrata e Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	e Komuna, donatorët	Prill 2020	Prill, 2020	Koncepti dhe propozimi janë përgatitur	
Parashtron propozimin për aprovim	Drejtorja për Zhvillim Ekonomik	Kryetari i Komunës	Prill 2020	Sa më parë që është mundur	Aprovimi është marrë	
Definimin	Drejtorja	për Kryetari dhe donatorët	Prill 2020	Prill 2020	Ligjërisht procesuar	është

⁶ Planet për veprim të dedikuara për projektet janë mostër sa më e përafërt me aktivitetet që komuna do të duhej ti ndërmerre pas përzgjedhjes së projekteve prioritare në secilin vit. Buxheti nuk planifikohet pasi që shumë projekte kryhen me vetkontribut dhe planifikimi bëhet pasi që të ndërmerren keto aktivitete.

Emri i aktivitetit	i Aplikuar nga	Përkrahur nga	Data fillimit	e Data përfundimit	e Rezultatet e pritura	Komentet
rregullativ	Zhvilim Ekonomik					
Identifikojë burimet finacimit	Administrata e Komunës & Donatorët	e Agjensionet partnere në Kosovë	Maj, 2020		Sa më parë që është mundur	Hartuesi dhe fondet për pajisje janë identifikuar
Hartimi	Ekzekutuesi	Administrata e Komunës	e Qershor, 2020		Për diskutuar	tu Aprovimi i dizajnit përfundimtar

Plani i Veprimit – Zona e veqant ekonomike për prodhues

Tabela 5 –Plani për Veprim për Zonën e veqant ekonomike për prodhues, Komuna e Vushtrrisë

Emri i aktivitetit	i Aplikuar nga	Përkrahur nga	Data fillimit	e Data përfundimit	e Rezultatet e pritura	Komentet
Përgatitja e një projekti	Administrata e Komunës	e Komuna, Prodhuesit	GLV, Maj, 2020	Korrik, 2020	Koncepti dhe propozimi janë përgatitur	
Parashtron propozimin për aprovim	Komuna	Komuna, dhe Qeveria e Kosovës	Bizneset e Gusht, 2020	Sa më parë që është mundur	Aprovimi është marrë	
Definimin rregullativ	Administrata e Komunës&Qeveria	e Qeveria	Tetor 2020	Nëntor 2020	Ligjërish procesuar	është
Identifikojë burimet financimit	Administrata e Komunës	e Qeveria	Korrik 2020	Sa më parë që është mundur	Hartuesi dhe fondet për pajisje janë identifikuar	
Hartimi	Ekzekutuesi	Administrata e Komunës dhe GLV	e Dhjetor 20120	Për diskutuar	tu Aprovimi i dizajnit përfundimtar	

REKOMANDIMET

- Komuna e Vushtrisë duhet të krijojë një task force për implementimin e planit të aktiviteteve.
- Komuna duhet të aktivizoj GLV Vicianum dhe të ia ngris kapacitetet për t'u marrë me implementimin e disa nga aktivitetet të cilat i përcaktohen nga Komuna.
- GL Komuna e Vushtrisë pas periudhës së pandemisë të merret menjëherë me implementimin e strategjisë duke e mbledhë bordin dhe akterët e tjerë për diskutimin e agjendës dhe ndarjes së përgjegjësisë.
- Në fund të secilit vit, komuna, ekspertët dhe akterët lokalë të mbajnë punëtori për evaluimin e strategjisë dhe përgatitjen e raportit të të arriturave të deritashme.
- Në fillim të secilit vit komuna duhet të mbajë punëtori për përzgjedhjen e projekteve prioritare dhe hartimin e agjendës për implementimin e tyre.
- Për secilin projekt, në secilin vit të përzgjedhjes si projekte prioritare, komuna duhet të përcaktoj përgjegjësit e projektit, aktivitetit apo programit që duhet të implementohet.
- Duke pas parasysh që komuna nuk ka buxhet të rregullt në baza vjetore, personat përgjegjës duhet të krijojnë marrëdhënje komunikimi dhe të i njoftojnë akterët të cilët janë sugjeruar për financim apo implementim të tyre.
- Komuna duhet të bëjë përpjekje maksimale që të angazhojë në forma të ndryshme të gjithë antarët e bordit dhe në mënyrë indirekte edhe grupet lokale.
- Të themelohen trupat e cekura të prodhuesve dhe të inkuadrohen në vendimarrjen komunale
- Sa më shpejt të rishiqohen dhe ndryshohen rregullorët komunale
- Të themelohen marrëdhënjet funksionale të komunës me të gjitha trupat e bizneseve dhe GLV.

- Të merren parasysh dhe implementohen të gjitha elementet dhe karakteristikat e konceptit LEADER.
- Të hulumtohet vazhdimisht për fonde (grante, financim, donacion) në të gjitha agjensitë kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat e mbështesin prodhuesit dhe konceptin LEADER dhe gjithashtu të kërkohet fonde për financimin e projekteve edhe nga agjensitë dhe institucionet tjera në favor të prodhuesve.
- Inkurajohet komuna që pamvarsisht përfundimit të marrëdhënjes kontraktuale me hartuesit e strategjisë të ju drejtohen atyre për sqarime dhe gjithashtu të ftohen në punëtoritë vjetore të vlersimit të performancës apo planit për vitin e ardhëshëm.

SHTOJCA I: KONTURAT E NJË PROJEKT PROPOZIMI

Emri i projektit

Emri i projektit duhet të jetë përshkruar në mënyrë të mjaftueshme, me qëllim që të kuptohet se çka është dhe se ku ndodhet.

Qëllimi i projektit

Qëllimi, pjesë e secilit është ky projekt duhet të theksohet në mënyrë specifike dhe të kuptueshme. Nëse strategjitë dhe projektet e tjera janë ose do të jenë pjesë e këtij qëllimi, deklarohuni se si ky projekt ndërlidhet dhe se cilat veprime parashikohen ose janë planifikuar për të përfunduar strategjitë e tjera, në mënyrë që të arrihet qëllimi i përgjithshëm.

Rezultatet e pritura

Përshkruaj rezultatet e pritura të projektit. Këto rezultate të pritura do të jenë objektivat që mund të maten për të parë nëse projekti është duke e përmbushur atë që keni përcaktuar të bëjë. Shembulli në vijim është ajo çka duhet : *Do të themelohet një qendër për përkrahje të projekteve dhe të biznesit. Ajo do të vendoset në një zyrë që aktualisht nuk është duke u shfrytëzuar dhe do ta ketë ekspertë të profileve të ndryshme që do të punojnë me orar të plotë. Kjo qendër do t'u ofroj shërbime të drejtpërdrejta profesionale bizneseve dhe do të jetë gjenerator për projekte. Pritet që gjatë vitit të parë të kontraktohen shtatë investitorë që punësojnë nga më së paku 10 puntorë të rinjë. Qendra do të organizojë rrjetin e marketingut të bizneseve dhe prodhojë plane të veprimt të zhvillimit ekonomik lokal.*

Lokacioni

Të jepen hollësitë se ku do të vendoset projekti. Komunitet e Kosovës po ballafaqohen me përgatitjen e planit të ardhshëm urbanistik; prandaj është domosdoshmëri përcaktimi i lokacionit për projektet e ndryshme. (Shënim: Shumë komuna e kanë identifikuar si pjesë të planeve të tyre strategjike, zhvillimin e zonave industriale, të inkubatorëve të biznesit dhe të projekteve të bujqësisë, për të cilat kërkohet hapësirë dhe lokacion, por në të shumtën e rasteve nuk janë identifikuar lokacionet për këto projekte.)

Afatet kohore

Përshkruaj se kur do të fillojë projekti dhe të identifikohen pikat e ndryshme të rëndësishme që do të arrihen gjatë implementimit të projektit. Paraqitni datën se kur pritet përfundimi i projektit. Afati kohor mund të paraqitet duke e përdorur një diagram të thjeshtë me pikat e rëndësishme,

për të siguruar tregues të qartë se kur do të realizohen detyrat e ndryshme dhe se kur do të përfundohet projekti.

Plani i veprimit

Plani i veprimit ose i punës paraqet në hollësi se për çka ka të bëjë projekti, dhe përshkruan renditjen e asaj se çka duhet të realizohet sipas një rendi të caktuar dhe nga kush, që projekti të përfundohet me sukses. Shkurtimisht, ai është plan i qartë dhe një grup udhëzimesh që i drejton ata të cilët do të implementojnë projektin. Kjo po ashtu u tregon agjencive financuese se ekziston një dizajn logjik. Plani i veprimit duhet të ketë lidhshmëri me datat e përcaktuara në seksionin e afateve kohore.

Detyrat konkrete dhe përgjegjësitë

Në këtë pjesë identifikohet se kush (individ, ekipi i komunitetit, kontraktuesi, etj.) ka përgjegjësinë për çdo detyrë ose aktivitete të identifikuar në planin e punës. Kjo e lidhë planin e punës dhe afatin kohor me individët specifik ose grupet e caktuara, të cilët do t'i realizojnë detyrat dhe aktivitetet.

Personat përgjegjës

Kjo është listë e plotë me ata individë dhe organizata që përgjigjen për implementimin e suksesshëm të projektit, siç janë ekipi i implementimit të projektit të GLV ose ekipi thelbësor.

Koordinimi

Kjo pjesë e propozimit përcakton se si ekipet e implementimit do të komunikojnë dhe do të koordinohen me agjencitë e tjera të zhvillimit lokal ose me planet rajonale. Propozimi duhet të identifikojë këto agjenci dhe të sqarojë hollësisht se si do të vendoset dhe të mbahet ky kontakt.

Strategjia e marrëdhënieve me publikun

Marrëdhëniet dhe komunikimi me publikun janë shumë me rëndësi për një zhvillim ekonomik lokal të suksesshëm. Prandaj, propozimi duhet të tregojë se cilat metoda ose procedura të shpërndarjes së informatave do të përdoren dhe kush do të jetë përgjegjës për marrëdhëniet dhe komunikimin me publikun gjatë implementimit të projektit. Këtu përfshihet edhe fakti se si do të përfshihen mediat për të avancuar punën e projektit dhe për të informuar komunitetin e gjerë rreth aktiviteteve të GLV.

Mundësitë për zhvillim të mëtejshëm

Përpjekja e planifikimit strategjik dhe projekti i GLV duhet të konsiderohen si fillim, e jo si fundi i procesit. Prandaj, në propozim duhet të përfshihet një tregues i projekteve, strategjive

dhe i qëllimeve që do të pasojnë në të ardhmen. Merrni parasysh se si projekti mund të shfrytëzohet si trampolinë për të vazhduar dhe zgjeruar përpjekjet e GLV pas implementimit të projektit të menjëhershëm, siç është fillimi i projekteve ose i strategjive të reja ose krijimi i institucioneve të reja për të vazhduar më tutje punën e GLV.

Buxheti

Buxheti duhet të ndërlidhet me planin e veprimit dhe afatin kohor. Ai duhet të jetë buxhet realistik që do të mundësojë përfundimin e projektit. Nëse jo, të propozohet se si do të merren fondet shtesë. Buxheti është element i rëndësishëm në propozim dhe do të përdoret si bazë për monitorimin e shpenzimit të fondeve, prandaj ai duhet të saktësojë njësitë se për çka do të shfrytëzohen paratë dhe se si do të shpenzohen ato.

Financime të tjera

Të përshkruhet çdo plan, si pjesë e propozimit ose në vazhden e planit strategjik, për të kërkuar financim nga donatorët e tjerë (qeveritë nacionale ose rajonale, organizatat e tjera financuese, ndihmesë teknike, etj.). Theksoni se kujt do t'i dorëzohen propozimet dhe për çfarë qëllimi.


Shtojca II: Buxheti i Propozuar për 5 vitet e ardhshme

Shtojca III: Përcaktimi i Treguesve Matës

“Treguesit e Bazuar në Performancë” janë vendosur në *Matricën për Monitorim dhe Raportim*.

Treguesit kryesor janë ndarë në mes të efekteve dhe rezultateve. *Efektet* maten në bazë të aktiviteteve të organizuara dhe rezultateve të arritura. Ato e përshkruajnë nivelin e efektivitetit dhe rezultateve të arritura si pjesë e vlerësimit të brendshëm dhe të vazhdueshëm. *Rezultatet* maten në bazë të ndikimit të arritur si pjesë e një vlerësimi të jashtëm i cili do të zhvillohet në baza periodike vjetore.

Mirëpo, siç edhe shihet në tabelën në vijim, arritjet dhe rezultatet do të realizohen vetëm me aktivitete të mjaftueshme të garantuar nga organet përgjegjëse komunale, me investime shtesë në burimet e jashtme (buxhet dhe personel) dhe përfshirje më të madhe të palëve të interesuara, p.sh. prodhuesit, fermerët lokal, grupet e interesit, ekspertët lokal, përfituesit, përkrahja direkte dhe indirekte publike etj.



PLANI I AKTIVITETEVE

Objektivi Specifik 1

Aktiviteti	Periudha e implementimit	Organet Përgjegjëse	Veprimet	Kosto financiare	Burimet e financimit	Sqarime plotësuese
Krijimi i Grupit për Implementimin e Strategjisë	Dhjetor 2020	Kryetari i Komunës	Një zyrtar publik për secilën drejtori	S'ka kosto financiare		GIS merret me shqyrtimin e menyrës së implementimit dhe I rekomandon kryetarit me plan vjetor dhe mujor
Kartela e Privilegjit	Dhjetor 2020	Drejtorja për Zhvillim Ekonomik Lokal	Identifikimi i prodhuesve; vendimi ose rregullorja për lehtësira	2500 euro në vit	Buxheti i Komunës, kategoria Mallra dhe Shërbime	kartela e privilegjon pronarin e saj me shërbime më të lehta dhe qasje në subvencionim
Përmirësimi i mëtutjeshëm i ofrimit të shërbimeve për bizneset – Standardizimi i Shërbimeve	Dhjetor 2020	Drejtorja e Administratës	Të vendosen rregullat e shërbimit	10.000 euro	Buxheti i Komunës, kategoria Mallra dhe Shërbime	Të hartohen shërbime standarde dhe të trajnohet stafi kompetent
Klubi i prodhuesve	Janar 2021	Kryetari i Komunës	Vendim i Kuvendit Komunal osë MoU ndërmjet prodhuesve dhe kryetarit	S'ka kosto financiare		Klubi i Prodhuesve krijohet si OJQ. Kryetari dhe Drejtori duhet të jenë antarë të Bordit
Rishqyrtimi dhe ndryshimi i rregulloreve komunale për përkrahje direkte dhe indirekte për prodhuesit.	Janar-Dhjetor 2021	Administrata komunale & Kuvendi Komunal	Analiza e rregulloreve dhe vendosja e qëllimeve për rregulloret e reja	S'ka kosto financiare		
Fondi Komunal për përkrahjen e prodhuesve	Janar -Shtator 2021	Kryetari & Drejtorja e Financave	Të planifikohet si pjesë e buxhetit apo si organ PPP	200.000 euro për çdo vit	Buxheti i Komunës dhe burimet e jashtme	Fondi mund të krijohet edhe si Fondacion me PPP
Zyra për Përkrahjen Profesionale dhe Teknike të Prodhuesve (mund të jetë si për të gjitha bizneset)	Shkurt, 2021	Kryetari	Të gjendet hapsira, të trajnohet stafi	10.000 në vit	Buxheti i Komunës	Mund të angazhohen edhe ekspert të jashtëm kohë pas kohe
Themelimi i zonës së veçant ekonomike për prodhues	Mars, 2021-Dhjetor 2022	Administrata komunale & MTI	Të aplikohet në MTI	25.000 euro themelimi; 1.5 milion ndërtimi	Komuna dhe MTI	

Laboratori i cilësisë dhe prodhimeve ushqimore	2021	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Lokal	Të fillohet me hartimin e koncept projektit dhe të aplikohet për financim	50.000-200.000 euro	Qeveria e Kosovës ose Agjensionet Ndërkombëtare	
Këshilli Ekonomik						KE është i elaboruar në SZHEL
Grupi Lokal i Veprimit Vicianum						GLV është e elaboruar në SZHEL
Ekspozimi i prodhimeve lokale në subjektet ekonomike të shitjes me pakicë	Janar, 2021	Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	Rregullore komunale	10.000 euro në vit	Buxheti i Komunës	
Maratona “Të Marshojmë për Prodhimet Vendore”, Vushtrri-Prishtinë	2021	Drejtoria e Kulturës	Regjistrimi në Federatën Atletike	5.000 euro në vit	Komuna dhe Qeveria	Duhet të jetë pjesë e VicianumFest
Panairi i prodhimeve vushtrriase i plotsuar edhe me një pjesë të kulturës-Prishtinë	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Kulturës	Të përfshihet si aktivitet në VicianumFest	5.000 euro në vit	Komuna e Vushtrrisë	
Konferenca me ekspertë dhe biznese vushtrriase në Prishtinë	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Kulturës	Të përfshihet si aktivitet në VicianumFest	5.000 euro në vit	Komuna e Vushtrrisë	
Dhurimi i pakove me prodhime vendore për qytetarë në nevojë-Prishtinë	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Kulturës	Të përfshihet si aktivitet në VicianumFest	5.000 euro në vit	Komuna e Vushtrrisë	
Hartimi i profilit të prodhuesve (dokument njoftues)	Dhjetor 2020	Drejtoria e Kulturës		10.000 euro	Komuna e Vushtrrisë dhe burimet e jashtme	Domument shtesë e Profilit të Komunës
Tregu lëvizës	2021	Drejtoria e Administratës		15.000 euro	Komuna e Vushtrrisë dhe burimet e jashtme	
Ngritja e profesionistëve të rinjë të kualifikuar për prodhim	2021	Drejtoria e Arsimit	Të jetë pjesë përbërëse e arsimit profesional dhe në bashkëpunim me biznese	S'ka kosto financiare		Të jetë pjesë përbërëse e arsimit profesional dhe në bashkëpunim me biznese

Trajnime dhe sesione informuese lidhur me praktikat bashkohore të menaxhimit të prodhimit	2021-2025	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik		5.000 euro në vit	Qeveria e Kosovës ose Agjensionet Ndërkombëtare	
Asistencë për plotësimin e standardeve dhe certifikim të produkteve vendore	2021-2025	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik		5.000 euro në vit	Qeveria e Kosovës ose Agjensionet Ndërkombëtare	
Inkuadrimi në vendimmarrjen e qeverisjes lokale, inkuadrimi në Këshillin Ekonomik, në Qendrën e Biznesit dhe GLV	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	Rregullorja ose Memorandumi		Qeveria e Kosovës ose Agjensionet Ndërkombëtare	
Emrimi i një përfaqësuesi të bizneseve në Asamblenë Komunale si vëzhgues	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	Rregullorja ose Memorandumi		Qeveria e Kosovës ose Agjensionet Ndërkombëtare	

Aktiviteti	Periudha e implementimit	Organet Përgjegjëse	Veprimet	Kosto financiare	Burimet e financimit	Sqarime plotësuese
Qendra e Biznesit	Dhjetor 2021	Kryetari i Komunës& Komuniteti I Biznesit	Themelimi I Qendres së Biznesit si subjekt (OJQ)	S'ka kosto financiare		Hartohet dhe nenshkruhet MoU I kryetarit dhe Qendrës së Biznesit
Qendra komunale për zhvillim ekonomik	Dhjetor 2021	Kryetari i Komunës& Komuniteti I Biznesit	Themelimi I Qendres së Biznesit si subjekt (OJQ)	S'ka kosto financiare		Hartohet dhe nenshkruhet MoU I kryetarit dhe Qendrës së Biznesit
Krijimi i Këshilli për zhvillim ekonomik lokal	Dhjetor 2021	Kryetari i Komunës& Komuniteti I Biznesit	Themelimi I Qendres së Biznesit si subjekt (OJQ)	S'ka kosto financiare		Hartohet dhe nenshkruhet MoU I kryetarit dhe Qendrës së Biznesit
Shërbime të përshtatshme one stop shop, online dhe telefon	Janar 2021	Drejtoria e Administratës	Identifikimi I Shërbimeve dhe standardizimi I tyre	Drejtoria e Administratës	5000	
Aktivizimi i zonës aktuale	Qershor 2021	Departamenti për Zhvillim Ekonomik Lokal	Hartimi I Planit të Menaxhimit	S'ka kosto financiare		Të fillohet me gjetjen e investitorve
Zona e veçant prodhuese për tërheqjen e investimeve të huaja	Janar/2021	Kryetari	Të planifikohet si pjesë e buxhetit dhe të kërkohet investime shtesë	3 milion	Komuna dhe Qeveria (MTI)	Finacimet kryesisht kërkohen nga KIESA
Themelimi i qendrës trajnuese dhe inovative (QTI)	Dhjetor 2021	Kryetari i Komunës& Komuniteti I Biznesit	Themelimi I Qendres së Biznesit si subjekt (OJQ)	S'ka kosto financiare		Hartohet dhe nenshkruhet MoU I kryetarit dhe Qendrës së Biznesit
Qendra promovuese apo Porta e Ekonomisë së Vushtrrisë	Dhjetor 2021	Kryetari i Komunës& Komuniteti I Biznesit	Themelimi I Qendres së Biznesit si subjekt (OJQ)	S'ka kosto financiare		Hartohet dhe nenshkruhet MoU I kryetarit dhe Qendrës së Biznesit
Inkubatori	2022	Dep. i Zhvillimit Ekonomik	Të fillohet me hartimin e koncept projektit dhe të aplikohet për financim	50.000-200.000 euro	Qeveria e Kosovës ose Agjencionet Ndërkombëtare	
Identifikimi i tokës që është pronë e Komunës	2021	Dep. i Zhvillimit Ekonomik		1500 euro		
Identifikimi i godinave që mund të përdorën për qëllime të biznesit				1500 euro		

Prodhimin e energjisë nga era	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria Urbanizmit dhe Planifikimit Hapesinor	Të harmonizohet me KIESA dh dhe të identifikohen potencialet	5.000 euro në vit	Komuna e Vushtrrisë	
Rregullore për përkrahjen e bizneseve (përfshihen kushtet dhe kritret, si psh punëtorët e rinjë i financohet 50% e pagës);	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Kulturës	Të përfshihet si aktivitet në VicianumFest	5.000 euro në vit	Komuna e Vushtrrisë	
Rregullore për përkrahjen e prodhuesve;	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Kulturës	Të përfshihet si aktivitet në VicianumFest	5.000 euro në vit	Komuna e Vushtrrisë	
Rregullore për krijimin e fondit për zhvillim ekonomik lokal (mund të krijohet si fondacion i jashtëm);	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Kulturës	Të përfshihet si aktivitet në VicianumFest	5.000 euro në vit	Komuna e Vushtrrisë	
Fondi për garanci kreditore;	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Kulturës	Të përfshihet si aktivitet në VicianumFest	5.000 euro në vit	Komuna e Vushtrrisë	Mund te krijohet edhe si kod buxhetor

Objektivi specifik 3

Aktiviteti	Periudha e implementimit	Organet Përgjegjëse	Veprimet	Kosto financiare	Burimet e financimit	Sqarime plotësuese
Krijimi i oazave bujqësore	2022	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Identifikimi i siperfaqeve të mundshme	10000 euro	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Fillohet menjëherë me rregulloren
Mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore	dhjetor/2020	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Plan I veqant	S'ka kosto financiare		kryhet nga stafi I Komunës
Aplikimi i Teknologjisë Moderne	dhjetor/2020	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Plan I veqant	S'ka kosto financiare		
Përfshirja e varieteteve të reja të perimeve dhe përmirësimi racor në blegtori	dhjetor/2020	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Plan I veqant	S'ka kosto financiare		kryhet nga stafi I Komunës
Përgatitja Profesionale dhe Stimulimi i Fermerëve	dhjetor/2020	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Plan I veqant	S'ka kosto financiare		
Aktivizimi i GLV Vicianum	Nëntor/2020	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Të ngriten kapacitetet dhe të i lejohet	1000	Komuna	
Kuvendi i GLV Vicianum	Nëntor/2020	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Të ngriten kapacitetet dhe të i lejohet		Komuna	
Strategjia e GLV Vicianum	Nëntor/2020	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Të ngriten kapacitetet dhe të i lejohet	25000	Komuna	Duhet patjetër të ahrtohet në mënyrë që të akreditohet
Akreditimi i GLV Vicianum	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Akreditimin e ben Ministria e Bujqësisë	50.000-200.000 euro	Qeveria e Kosovës ose Agjensionet Ndërkombëtare	
Krijimi i kooperativave	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Bëhet identifikimi i mundësive			

Objektivi Specifik 4

Aktiviteti	Periudha e implementimit	Organet Përgjegjëse	Veprimet	Kosto financiare	Burimet e financimit	Sqarime plotësuese
VicianumFest	2021	Drejtoria e Kulturës	Identifikimi I eventeve të Komunës	20.000 euro		
Shpallja e Vushtrisë si Kryeqytet Historik	2021	Drejtoria e Kulturës	Vendimi i Kryetarit për shpalljen e Vushtrisë Kryeqytet Historik;	S'ka kosto financiare		Niveli politik duhet të ketë pajtueshmëri
Licencimi i familjeve mikpritëse në zonat rurale	Nëntor/2020	Drejtoria e Kulturës	Rregullore komunale për familjet mikpritëse	0		Familjet që e kanë mbajtur traditën duhet të kenë përparësi
Krijimi i kushteve për investime në bio-turizëm	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Kulturës	Mund të I bartet si aktivitet I Vicianum GLV			Studim I veçant për mundësitë
Krijimi i guidës turistike një javore ku do të përfshihen vizita të objekteve historike dhe kulturore, qëndrimit në familje bujqësore dhe blegtorale, pjesëmarrjes së turistëve në prodhim dhe përpunim të produkteve	2021	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Kulturës	Mund të I bartet si aktivitet I Vicianum GLV			Studim I veçant për mundësitë
Krijimi i Komitetit (Këshillit) Turistik për zhvillimin e turizmit	2022	Drejtoria e Kulturës	Rregullore komunale për familjet mikpritëse	0		
Ndërtimi Haneve	2022	Drejtoria e Kulturës	Rregullore komunale	0		
Licencimi i ciceronëve		Drejtoria e Kulturës				
Maratona "Vrapojmë me Prodhuesit Vendor"		Drejtoria e Kulturës	Kordinim me federatën e Atletikës së Kosovës			